

Identifikimi Paraprak i Problematikave Kryesore të Menaxhimit të Ujërave në Basenin Ujor Ishëm dhe Basenin Ujor Erzen



**Dokument për konsultimin paraprak me
agjencitë qeveritare dhe ekspertët teknikë
Maj 2020**



**Pjesë e dokumentacionit të Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore
për Basenin Ujor Ishëm dhe për Basenin Ujor Erzen**

Tabela e përmbajtjes

1. PËRMBLEDHJE E PLANIFIKIMIT TË BASENEVE UJORE	1-1
1.1 KONTEKSTI LIGJOR	1-1
1.2 HAPAT KYÇË.....	1-1
1.3 KOHËZGJATJA E PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR	1-2
1.4 PROBLEMATIKAT KRYESORE TË MENAXHIMIT TË UJËRAVE NË BASENET UJORE ISHËM E ERZEN ...	1-2
2. MËNYRA SE SI KEMI PROJEKTUAR KËTË KONSULTIM.....	2-1
2.1 TEMAT KYÇË.....	2-1
2.2 PËRMBAJTJA E TEMËS DHE METODOLOGJIA E VLERËSIMIT	2-1
2.3 DHËNIA E OPINIONI / KONTRIBUTIT MBI KËTË DOKUMENT	2-3
2.4 PËRMBLEDHJE.....	2-4
3. BASENET UJORE TË ISHMIT DHE ERZENIT	3-4
3.1 BASENI UJOR I LUMIT ISHËM	3-4
3.1.1 ISHËM 4 (ISH4).....	3-4
3.1.2 ISHËM 3 (ISH3).....	3-4
3.1.3 ISHËM 2 (ISH2).....	3-5
3.1.4 ISHËM 1 (ISH1).....	3-5
3.1.5 ISHËM 0 (ISH0).....	3-5
3.2 BASENI UJOR I ERZENIT	3-5
3.2.1 ERZEN 4 (ERZ4)	3-5
3.2.2 ERZEN 3 (ERZ3)	3-5
3.2.3 ERZEN 2 (ERZ2)	3-5
3.2.4 ERZEN 1 (ERZ1)	3-5
3.2.5 ERZEN 0 (ERZ0)	3-6
4. NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE BURIMET UJORE	4-1
4.1 RËNDËSIA E KËSAJ TEMATIKE	4-1
4.2 SITUATA AKTUALE.....	4-1
4.3 NDËRLIKIMET DHE NEVOJAT E ARDHSHME.....	4-2
4.4 MASAT E MUNDSHME PËR ZBATIM BRENDA PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR	4-3
5. SISTEMET E MONITORIMIT HIDROMETEOROLOGJIK DHE SISTEMET E TË DHËNAVE.....	5-1
5.1 RËNDËSIA E KËSAJ TEMATIKE	5-1
5.2 SITUATA AKTUALE.....	5-1

5.3	NDËRLIKIMET DHE NEVOJAT E ARDHSHME.....	5-2
5.4	MASAT E MUNDSHME PËR ZBATIM BRENDA PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR	5-3
6.	<u>ZONAT E MBROJTURA DHE EKOSISTEMET UJORE.....</u>	6-1
6.1	RËNDËSIA E KËSAJ TEMATIKE	6-1
6.2	SITUATA AKTUALE.....	6-1
6.3	NDËRLIKIMET DHE NEVOJAT E ARDHSHME.....	6-2
6.4	MASAT E MUNDSHME PËR ZBATIM BRENDA PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR	6-3
7.	<u>PËRMBYTJET DHE THATËSIRAT</u>	7-1
7.1	RËNDËSIA E KËSAJ TEMATIKE	7-1
7.2	SITUATA AKTUALE.....	7-1
7.3	NDËRLIKIMET DHE NEVOJAT E ARDHSHME.....	7-2
7.4	MASAT E MUNDSHME PËR ZBATIM BRENDA PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR	7-3
8.	<u>MORFOLOGJIA DHE VIJIMËSIA E KANALEVE DHE LYMISHTAVE</u>	8-1
8.1	RËNDËSIA E KËSAJ TEMATIKE	8-1
8.2	SITUATA AKTUALE.....	8-1
8.3	NDËRLIKIMET DHE NEVOJAT E ARDHSHME.....	8-2
8.4	MASAT E MUNDSHME PËR ZBATIM BRENDA PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR	8-3
9.	<u>PRURJA EKOLOGJIKE</u>	9-1
9.1	RËNDËSIA E KËSAJ TEMATIKE	9-1
9.2	SITUATA AKTUALE.....	9-1
9.3	NDËRLIKIMET DHE NEVOJAT E ARDHSHME.....	9-2
9.4	<u>MASAT E MUNDSHME PËR ZBATIM BRENDA PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR</u>	9-3
10.	<u>PËRDORIMI I UJIT, NXJERRJA E UJIT DHE LEJA PËR NXJERRJE</u>	10-4
10.1	RËNDËSIA E KËSAJ TEMATIKE	10-4
10.2	SITUATA AKTUALE	10-4
10.3	NDËRLIKIMET DHE NEVOJAT E ARDHSHME	10-5
10.4	MASAT QË MUND TË ZBATOHEN NË PLANIN E MENAXHIMIT PËR BASENIN UJOR.....	10-6
11.	<u>SHKARKIMET E UJIT, NDOTJA E UJIT DHE LEJA PËR SHKARKIM.....</u>	11-1
11.1	RËNDËSIA E KËSAJ TEMATIKE.....	11-1
11.2	SITUATA AKTUALE	11-1
11.3	NDËRLIKIMET DHE NEVOJAT E ARDHSHME	11-2
11.4	MASAT QË MUND TË ZBATOHEN NË PLANIN E MENAXHIMIT PËR BASENIN UJOR.....	11-3

12. DIGAT DHE HIDROCENTRALET	12-4
12.1 RËNDËSIA Ë KESAJ TEMATIKE.....	12-4
12.2 SITUATA AKTUALE	12-4
12.3 NDËRLIKIMET DHE NEVOJAT E ARDHSHME	12-6
12.4 MASAT E MUNDSHME PËR ZBATIM BRENDA PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR.....	12-7
13. PËRDORIMI, MBROJTJA DHE MONITORIMI I UJËRAVE NËNTOKËSORE	13-1
13.1 RËNDËSIA E KËSAJ TEMATIKE.....	13-1
13.2 SITUATA AKTUALE	13-1
13.3 NDËRLIKIMET DHE NEVOJAT E ARDHSHME	13-2
13.4 MASAT E MUNDSHME PËR ZBATIM BRENDA PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR.....	13-4
14. CILËSIA DHE HABITATET E UJIT TË BREGDETIT DHE UJËRAVE TË LARJES.....	14-1
14.1 RËNDËSIA E KËSAJ TEMATIKE.....	14-1
14.2 SITUATA AKTUALE	14-1
14.3 NDËRLIKIMET DHE NEVOJAT E ARDHSHME	14-3
14.4 MASAT E MUNDSHME PËR ZBATIM BRENDA PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR.....	14-4
15. NGRITJA E NIVELIT TË UJIT NË BREGDET, RREZIKU NGA PËRMBYTJET, EROZIONI DHE VËRSHIMET	15-1
15.1 RËNDËSIA E KËSAJ TEMATIKE.....	15-1
15.2 SITUATA AKTUALE	15-2
15.3 NDËRLIKIMET DHE NEVOJAT E ARDHSHME	15-2
15.4 MASAT E MUNDSHME PËR ZBATIM BRENDA PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR.....	15-3
PROCEDURA E DHËNIES SË KOMENTEVE	15-5

Deklarata e pajtueshmërisë

Ky dokument iu përmbahet të gjitha kërkesave të Nenit 15 dhe Nenit 17 të Ligjit “Për Konsultimin Publik”.

Ky dokument ka për qëllim t'i përmbahet Nenit 14 të Direktivës 2006/60/EC së BE-së, Konsultimi publik për zhvillimin e Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore.

Shënim

Të nderuar kolegë dhe profesionistë të mjedisit, në vijim të **Deklaratës** këshilluese paraprake për **Masat e Konsultimit** të bërë nga Agjencia Shqiptare për Menaxhimin e Burimeve Ujore (AMBU), në shtator të vitit 2019, ju urojmë mirëseardhjen në hapin e radhës së përgatitjes së **Planit zyrtar të Menaxhimit të Baseneve Ujore (PMBU)** për basenet ujore **Ishëm dhe Erzen**.

Ky Plan po përgatitet nga **Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore (AMBU)** nën drejtimin e Këshillave të Baseneve Ujore Ishëm dhe Erzen, dhe Këshillit Kombëtar për Ujin. Ky konsultim ka për qëllim të mbështesë kërkesat e Nenit 14.1 (b) të Direktivës Kuadër të Ujit (DKU) të Bashkimit Evropian (BE), për t'iu mundësuar palëve të interesit një "Përmbledhje të ndërmjetme të problematikave kryesore të menaxhimit të ujërave" dy vite përpara nisjes së periudhës së referuar në plan (në rastin konkret, në muajin janar 2022).

Objektivi kryesor i këtij dokumenti është krijimi i një vështrimi të përgjithshëm jo-teknik e asaj ç'ka konsiderohen si sfidat më madhore, të lidhura me menaxhimin e ujit në baseet e lumenjve Ishëm dhe Erzen. Së dyti, me qëllim nxitjen e reagimit dhe diskutimit nga palët e interesit (përcaktuar si publiku i gjerë dhe operatorë të tjerë, konsumatorët ose përdorues të shërbimeve të ujit që përfitojnë nga burimet ujore ose shërbimet e ekosistemit në basenin ujqor), AMBU propozon veprime të mundshme, të ndryshme ose masa menaxhuese me qëllim për një mirëmenaxhim ose mbrojtjen dhe përmirësimin e lumenjve, liqeneve dhe vijës bregdetare sipas standarteve të nevojshme europiane.

Bazuar në përdorimin e paqëndrueshëm dhe në cilësinë jo të mirë të ujërave në shumë basene ujore, ne kemi nevoja urgjente për përmirësimin, menaxhimin dhe forcimin e përdorimit të këtyre burimeve të çmuara, burimeve ujore. Deklaratat e cituara në këtë dokument janë një vështrim paraprak i AMBU-së si autoriteti përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit të baseneve ujore, por në përputhje të plotë me kërkesat dhe procedurat e parashikuara në Vendimin nr. 1 datë 17.2.2015 të Këshillit Kombëtar të Ujit, ku shprehet se Këshilli i Basenit Ujqor (KBU), në çdo basen ujqor, duhet të marrë masat që të gjitha palët e interesit, përfshi publikun e gjerë, të kenë mundësinë të shprehin opinionet dhe vështrimet e tyre profesionale mbi planin e propozuar. Plani i menaxhimit i basenit ujqor final i publikuar duhet gjithashtu, të marrë parasysh të gjitha reagimet dhe opinionet e përfutuara gjatë procesit të konsultimit, kur ato janë relevante në aspektin social, teknik apo dhe ekonomik.

Në seksionet në vijim të këtij dokumenti ne kemi përcaktuar disa tematika kryesore, të cilat janë konsideruar si prioritare nga AMBU dhe në të njëjtën kohë, disa zgjidhje të mundshme respektivisht. Në disa raste, propozimet tona mund të kenë nevojë për ndryshime në politika, procedura operationale të përdoruesve të mëdhenj të ujit, si për shembull Ujësjiellës-Kanalizimet, ujitja, prodhimi i hidroenergjisë, përmirësimi i grumbullimit të të dhënave dhe forcimi i kuadrit rregullator nga institucionet kombëtare. Janë pikërisht këto palë interesi të cilët ftohen, në këtë fazë, të japin kontributin ose komentet e tyre lidhur me propozimet tona fillestare.

Nënshkroi

Drejtori i Përgjithshëm, AMBU *Gerta Lubonja*

1. Përmbledhje e planifikimit të baseneve ujore

1.1 Konteksti ligjor

Si pjesë e kriterëve të anëtarësimit në BE për Shqipërinë, ne duhet që t’iu përmbahemi plotësisht kushteve dhe detyrimeve të “Kreut 27: Mjedisi dhe ndryshimet klimatike” të legjislacionit të BE-së (kushtet për anëtarësimin). **Planet e Menaxhimit të Baseneve Ujore (PMBU-të)** të konsultuara formalisht dhe të hartuara ligjërisht përbëjnë një pjesë thelbësore të detyrimeve të përcaktuara në Kreun 27. Komisioni Evropian ka identifikuar një sërë hapësirash, ku nevojiten përpjekje të shtuara nga ana e Qeverisë shqiptare dhe agjencive rregullatore, përta i takon ujërave dhe mbrojtjes së mjedisit.

Shtetet Anëtare e konsiderojnë Direktivën Kuadër të Ujit si një nga pjesët më kyçe të legjislacionit mjedisor, për të mbrojtur dhe përmirësuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e ujërave sipërfaqësore, ujërave nëntokësore dhe atyre detare. Të gjitha Shtetet Anëtare kanë detyrim ligjor hartimin dhe publikimin e PMBU-ve për basenet e tyre ujore përkatëse. Shqipëria ka shtatë basene ujore të menaxhuara nga “Zyrat e Administrimit të Baseneve Ujore” përkatëse, sipas përcaktimeve të VKM-së Nr. 342 (4.05.2016).

Uji është burimi ynë natyror më jetik dhe më i rëndësishëm. Ai është në sasi të kufizuar, prandaj, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 6/2018, uji duhet të rregullohet në mënyrë të tillë, që përdorimi i tij të jetë në proporcion me nevojën, i qëndrueshëm ndaj mjedisit dhe ekonomikisht produktiv.

Megjithëse mund të ekzistojnë strategji sektoriale, si për shembull, nxjerrjes së ujit nga bashkia, trajtimit të ujërave të ndotura, përdorimit të ujit për vaditje, përdorimit të ujit për zhvillim industrial dhe ekonomik, zhvillimit energjetik në formën e hidrocentraleve ose strategjisë kombëtare për mbrojtjen mjedisore, të gjitha këto strategji sektoriale duhet të jenë të balancuara dhe të koordinuara brenda kuadrit të objektivave të PMBU-së së botuar. Në veçanti, duhet të identifikohet plotësisht kostoja e lartë mjedisore e nxjerrjes së ujit nga mjedisi dhe përdorimi i tij në ekonomi, si dhe duhet të rikuperohet kjo kosto në përputhje me masat e përcaktuara në PMBU.

1.2 Hapat kyçë

Hapat kyç që duhen ndërmarrë janë të përcaktuar qartazi në **Direktivën Kuadër të Ujit të BE-së (Shtojca VII)**. Ligji Shqiptar i Ujit (Nr. 111/2012, i ndryshuar me Ligjin Nr. 6/2018) përcakton gjithashtu se çfarë duhet të përfshihet në përmbajtjen e PMBU-së. Hapat kyç për përgatitjen dhe konsultimin me palët e interesit përcaktohen nga Vendimi Nr. 1 (Shkurt 2015) i Këshillit Kombëtar të Ujit.

Fillimisht duhet të realizohet karakterizimi i i basenit ujqor në lidhje me trupat ujqor (lumenjtë, liqenet, ujërat nëntokësore dhe zonat bregdetare), dhe tipin specifik i kushteve të referencës, në mënyrë që të identifikojmë trupat ujqorë standarte tregues të “statusit të mirë”, të cilat përfshijnë stadartet cilësore dhe sasiorë të ujërave.

Në mënyrë që të kuptojmë se përse kemi trupa ujorë me devijim nga "statusi i mirë", ne duhet të përgatisim një vlerësim teknik mbi basenin ujor, i cili identifikon presionet dhe impaktin mbi burimet ujore.

Zyra e Administrimit të Basenit Ujor, referuar Ligj nr. 111/2012 i ndryshuar me Ligj nr. 6/2018, duhet të përgatisë një analizë përmbledhëse ekonomike mbi përdorimin e ujit në këtë basen ujor, ne veçanti për të përcaktuar nëse uji po përdoret me efikasitet dhe nëse është e vërtetë që kosto mjedisore po rikuperohet nga përdoruesit.

1.3 Kohëzgjatja e Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor

Një plan menaxhimi i basenit ujor ka një kohëzgjatje prej **gjashtë vitesh**. Aktualisht, Shtetet Anëtare në Evropë po zbatojnë **ciklin e dytë** të PMBU-ve të tyre (2016-2021), si dhe po përgatiten për **ciklin e tretë** (2022-2027). Këshilli Kombëtar i Ujit është i mendimit se Shqipëria duhet të tregojë angazhimin e saj ndaj procesit të anëtarësimit në BE nëpërmjet zbatimit të planeve të saj të para, të cilat iu përmbahen plotësisht kushteve të përcaktuara, në mënyrë që të harmonizohet me ciklin e tretë të PMBU-ve të BE-së, konkretisht ato të vitit 2022-2027, ndaj pritet që Plani i Menaxhimit të Baseneve Ujore të Ishmit dhe Erzenit do të zbatohet në periudhën 2022-2027.

1.4 Problematikat Kryesore të Menaxhimit të Ujërave në basenet ujore Ishëm dhe Erzen

Sfidat e menaxhimit të ujërave që hasim në Shqipëri janë të konsiderueshme dhe vijnë për shkak të lënies pas dore dhe keqmenaxhimit të burimeve tona ujore përgjatë historisë. Ndoshta do të nevojiten disa periudha planifikimi për basenet ujore (6-24 vite) për të arritur të gjitha **objektivat mjedisore** dhe për të siguruar që përdorimi i ujit është i qëndrueshëm në planin afatgjatë.

Disa nga këto sfida hasen në shkallë rajonale, të tilla si reduktimi i mundshëm afatgjatë i disponueshmërisë së burimeve ujore kryesore për shkak të ndryshimeve klimatike. Disa nga sfidat e tjera hasen në shkallën mikro, si për shembull shfrytëzimi pa leje i ujërave nëntokësore, që ndodh përgjatë gjithë rajonit bujqësor në vend, të cilat mund të çenojnë qëndrueshmërinë afatgjatë të rezervave të pazëvendësueshme të ujërave nëntokësore dhe gjithashtu, shkarkimi i ujërave të ndotura urbane në lumenj.

Megjithëse nuk mund të adresojmë dhe zgjidhim çdo problematikë në PMBU-në e parë për basenet Ishëm dhe Erzen, duhet të bëjmë përpjekje për të identifikuar problematikat më të rëndësishme dhe serioze, si dhe të ofrojmë një sugjerim për mënyrën se si planifikojmë që t'i menaxhojmë ato nëpërmjet planeve sistematike dhe të strukturuar të veprimtarive që do të kryhen, i ashtuquajtur ndryshe **Programi i Masave**, në mënyrë që të sigurojmë se kemi sasinë dhe cilësinë e mjaftueshme të ujit për përdorim afatgjatë. Në veçanti, këtu përfshihen dhe nevojat e ekosistemeve të vyera ujore në vend.

Në periudhën gjashtë mujore të konsultimeve nga muaji janar 2020 deri në qershor 2020, gjatë së cilës AMBU-ja do të zhvillojë gjithashtu **draft Planin e Menaxhimit të Basenit Ujor**, palët e interesit mund të identifikojnë problematika me rëndësi, të cilat nuk janë të

përmendura në Përmbledhjen e parë, dhe më pas AMBU-ja do të kryejë shqyrtimin e tyre. Fillimisht, ne propozojmë që problematikat kryesore të mundshme të paraqiten në titujt kryesorë të përcaktuar në Tabelën 1-1.

Ky dokument nuk ka natyrë teknike, por është një përmbledhje e thjeshtëzuar me qëllim të kuptohet dhe komentohet nga publiku i gjerë dhe përdoruesit e burimeve ujore përpara hartimit dhe publikimit të një draft-plani menaxhimit të basenit ujor, i cili është më i plotë, teknik dhe gjithëpërfshirës, për t'u publikuar brenda Dhjetor 2020.

Tabela 1-1 – Përmbledhje e Temave Kryesore të Menaxhimit të Ujërave

Tema kryesore	Komente mbi presionet, gjendjen ose ndikimet kryesore
MJEDISI	PROBLEMATIKA TË MUNDSHME
Ndryshimet klimatike dhe burimet ujore	<ul style="list-style-type: none"> • Reduktimi i pritur prej -8% në sasinë e reshjeve deri në vitin 2025 • Reduktimi i pritur prej -20% në sasinë e reshjeve deri në vitin 2050 • Ndikimet e konsiderueshme të pritura në disponueshmërinë e ujit për të gjithë përdorimet
Sistemet e të dhënave hidrometeorologjike dhe monitorimit	<ul style="list-style-type: none"> • Mosfunksionimi i sistemit për monitorimin e ujërave sipërfaqësore që prej vitit 2000 • Mungesa e të dhënave të kohëve të fundit rreth ndryshimeve klimatike apo analizave të burimeve ujore për ujërat sipërfaqësore ose nëntokësore
Zonat e mbrojtura dhe ekosistemet ujore	<ul style="list-style-type: none"> • Mospërcaktimi i kufijve dhe mungesa e mbrojtjes së burimeve të ujit të pijshëm • Mosrespektimi i zonave të mbrojtura natyrore dhe mos përkufizimi i shumë habitateve Natura 2000 të mundshme.
Përmbytjet dhe thatësitrat	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e Planit për Menaxhimin e Rrezikut nga Përmbytjet • Mungesa e Planit për Menaxhimin e Rrezikut nga Thatësira
Morfologjia dhe vijimësia e kanaleve dhe lymishtave	<ul style="list-style-type: none"> • Nxjerrja e jashtëligjshme e zhavorrit dhe habitatet e shkatërruara • Pengesat në vijimësinë e lumenjve për shkak të barazheve, digave dhe hidrocentraleve
Rrjedhat mjedisore	<ul style="list-style-type: none"> • Mospërcaktimi i qartë i rrjedhave mjedisore për asnjërin nga lumenjtë • Degradimi i konsiderueshëm i diversitetit të specieve për shumë ekosisteme ujore
PËRDORIMI I UJIT	PROBLEMATIKA TË MUNDSHME
Përdorimi i ujit, nxjerrja e ujit dhe leja për nxjerrje	<ul style="list-style-type: none"> • Përdorimi jo-eficient i ujit nga bashkia, me humbje reale prej +60%. • Sistemi i paplotë i dhënies së lejeve me nxjerrje të shumta të paregjistruara • Mosrikuperimi i plotë i kostove dhe ndikimeve të përdorimit të ujit nga Operatorët
Shkarkimet e ujit, ndotja e ujit dhe leja për shkarkim	<ul style="list-style-type: none"> • Mostrajtimi i ujërave të ndotura urbane në Tiranë apo rrethinat e saj • Degradimi dhe ndotja e lartë e lumenjve kryesorë • Mosarritja e mundshme e standardeve të nevojshme të cilësisë mjedisore të lejeve të shkarkimit

Digat dhe hidrocentralet	<ul style="list-style-type: none"> Dëmtimet e konsiderueshme të ekosistemeve ujore nga veprimtaria e hidrocentraleve Ndërprerja e vijimësisë së ekosistemit nga digat
Përdorimi, mbrojtja dhe monitorimi i sistemeve nënujore	<ul style="list-style-type: none"> Nxjerrja e tepërt e pakontrolluar e ujërave nëntokësore Sistem monitorimi i papërshtatshëm për mbikqyerjen e cilësisë dhe sasisë së ujit Rreziku nga përmbytjet të brigjeve detare nga ujërat e detit
MENAXHIMI I VIJËS BREGDETARE	PROBLEMATIKA TË MUNDSHME
Cilësia e ujërave, ujërat e largjes, habitatet	<ul style="list-style-type: none"> Rreziku ndaj shëndetit njerëzor për shkak të ndotjes së rrjedhës së sipërme Degradimi i habitateve bregdetare për shkak të depozitimit të mbetjeve të ngurta
Ngritja e nivelit të detit, erozioni, rreziku nga përmbytja dhe vërshimi në bregdet	<ul style="list-style-type: none"> Rreziku i konsiderueshëm përmbytjeje nga projektimet për ngritjen e nivelit të detit në masën 0,2 - 0,3 m deri në vitin 2050 Rritje e presionit ndaj ujërave nëntokësore për shkak të ngritjes së nivelit të detit

2. Mënyra se si kemi projektuar këtë konsultim

2.1 Temat kyçe

Tabela 1-1 në seksionin e mëparshëm përmbledh temat që AMBU-ja i konsideron kryesore dhe që duhet të adresohen deri në një farë mase në Planin e Menaxhimit të Basenit Ujor. Këto problematika nuk do të jenë domosdoshmërisht me interes për të gjithë Ekspertët. Për këtë arsye, konsultimi duhet të konsiderohet si një sërë problematikash të pavarura (megjithëse thuajse të gjitha burimet ujore dhe përdorimet e tyre në një basen ujor lidhen me njëra-tjetrën), dhe ne kërkojmë komentet dhe përshtypjet e Ekspertëve lidhur me problematikat që ai/ajo ka kompetencë.

AMBU dhe autoritetet e tjera kompetente nuk do të jenë në gjendje të zgjidhin çdo problematikë në ciklin e parë të planit të menaxhimit të basenit ujor. Megjithatë, ne duhet së paku, të identifikojmë sfidat më emergjente brenda secilës tematikë, si dhe ato prioritete të cilat mund të kërkojnë vëmendje më të madhe në planet e menaxhimit të tjera në vazhdim.

2.2 Përmbajtja e temës dhe metodologjia e vlerësimit

Në seksionet 4 deri në 15 në këtë dokument jepet një përmbledhje për secilën temë. Problematikat mund të jenë identifikuar nga burime të ndryshme, për shembull të dhënat zyrtare hidrometereologjike, programet mjedisore të monitorimit, studime teknike universitare, operatorë apo konsulentë, agjenci ndërkombëtare, apo edhe grupet lokale e OJF-të. Në këtë fazë janë relevante të gjitha opinionet dhe këndvështrimet, por këto duhet të studiohen në mënyrë më rigoroze brenda draft Planit të menaxhimit të basenit ujor.

Në mënyrë që të përcaktohet nëse duhet të ndërmerret veprim korigjues apo parandalues për ndonjërin nga temat e përgjithshme apo nënbasenet, duhet që fillimisht, nëpërmjet opinionit të ekspertëve dhe vlerësimit teknik, të përcaktojmë **presionet** dhe **ndikimet** e presioneve të shkaktuara nga njeriu. Së fundmi, duhet që të përcaktojmë se cilat janë reagimet apo veprimet e duhura (**programi i masave**) që duhet të ndërmarrim për të:

- a) ruajtur dhe mbrojtur qëndrueshmërinë e burimeve dhe ekosistemeve tona ujore;
- b) siguruar që të gjitha ujërat përdoren në mënyrë efikase, produktive dhe në të njëjtën kohë pa dëmtuar mjedisin;
- c) përmbushur kërkesat e ndryshme të ligjit kombëtar të ujit dhe Direktivave të BE-së.


Gjendja e mjedisit është e ndryshme në pjesë të ndryshme të basenit ujor, në varësi të presioneve, ndaj një ndërlikim i mëtejshëm është nevoja e mundshme për të ndërmarrë veprime të posaçme për zona të ndryshme.

Për këtë arsye, e kemi ndarë basenin ujor në njësi më të vogla hapësinore, të quajtura nënbasene, të cilat pritet të kenë presione të ndryshme (dhe për pasojë dhe problematika e zgjidhje të ndryshme). Në PMBU-në përfundimtare të miratuar, duhet që niveli i analizimit tonë të përfshijë dhe trupa ujorë individualë (lumenj, liqene, ujërat nëntokësore dhe ujërat detare), por për thjeshtësi, ky konsultim i parë përqendrohet fillimisht vetëm në temat e përgjithshme dhe nënbasenet kryesore të baseneve ujore.

Kjo qasje metodologjike e këtij konsultimit (dhe që do të përdoret dhe në PMBU-në) është e ashtuquajtura **Metoda DPSIR** (Figura 2-1), në të cilën bazohet dhe vetë Direktiva Kuadër e Ujit.

Si rrjedhojë, komentet tuaja gjatë konsultimit mund të adresojnë ndonjë (ose të gjitha) nga proceset ciklike që paraqiten në Figurën 2-1. Zakonisht, në një Plan për Menaxhimin e Basenit Ujor, fokusi është te gjendja dhe ndikimet, si dhe te komentet për t'i adresuar këto ndikime, por siç paraqitet në Figurën 2-1, reagimi(et) i nivelit drejtues mund të adresojë edhe problematika të niveleve më të larta, siç janë forcat nxitëse të ndryshimeve klimatike, shtimi i popullsisë dhe/ose zhvillimi ekonomik, në mënyrë që të lehtësohen presionet e identifikuara në nivel vendor.

Figura 2-1 – Metoda DPSIR në Direktivën Kuadër të Ujit



Forcat

Industria, energjia, bujqësia, akuakultura, shtëpitë, turizmi, klima, gjeologjia.

nxitëse:

Presionet:

Ndryshimet klimatike, ndotja në burim, ndotja në shpërndarje, nxjerra e ujit, ndërhyrja fizike.

Gjendja:

Cilësia e ujit, gjendja e ujërave nëntokësore, gjendja ekologjike (kimike, fizike, biologjike).

Ndikimet:

Humbje e habitateve/specieve, thatësira/përmbytje, kripëzim; eutrofikim; acidifikim.

2.3 Reagimet:

Kufizime në përdorimin e ujit; Burime alternative; Çmime të subvencionuara të ujit; Informacion i përmirësuar; Menaxhim i kërkesës; Marrëveshje vullnetare; Konflikt rajonal; Trajtim i ujërave të ndotura; Rezervuare; Dhënia e opinionit / kontributit mbi këtë dokument

Përgjigjet tona (veprimet) në programin e masave do jenë të një natyre tjetër. Disa do jenë në nivel politik dhe strategjik, disa mund të kërkojnë përmirësime në forcimin e kuadrit rregullator apo monitorimit nga institucionet kompetente dhe të tjera masa teknike do të propozohen, për shembull: reduktimi i humbjes së ujit ose përdorim pa leje/autorizim i ujit, rritja e prurjeve mjedisore ose minimizimi i sasisë së ndotësve nga aktivitetet urbane apo industriale, nëpërmjet kushteve të lejes/autorizimit të ujit. Kjo do të thotë që AMBU mund të kërkojë kërkesa shtesë, më të rrepta, ndaj përdoruesve të ujit gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre në përdorim, monitorim apo raportimin e shfrytëzimit të burimeve ujore, si për shembull: për të kontrolluar kështu më mirë statusin e impaktit në mjedisin ujqor. Kjo në vetvete është një masë brenda programit të masave.

Në fund të çdo seksioni, ne kemi përmbledhur problematikat më përshtatshme për secilën temë. Një format komenti / kontributi për palët e interesit gjendet si një shtojcë e veçantë e këtij dokumenti, për të përcjellë komentet apo opinionet për secilën problematikë bazuar në një listë të paracaktuar pyetjesh. Natyrisht, ka hapsira për të shtuar komente apo observime të tjera. Qytetarët e thjeshtë apo operatorët e mëdhenj të shërbimeve ujore mund të përdorin të njëjtën format për dhënien e kontributit të tyre. Format i përgjigjes i paraqitur në shtojcë mund të shkarkohet si një dokument i veçantë në faqen zyrtare ambu.gov.al.

Secila palë e interesit duhet të plotësojë të dhënat bazike në mënyrë që të kontaktohen më tej, në rastet kur nevojitet, detaje apo komente shtesë. Nëse keni ekspertizë teknike të rëndësishme apo burime të dhënash, të cilat mund të jenë të vlefshme për të dhënat bazë të planit të menaxhimit të basenit ujqor, ju lutem listojini ato në formatin e përgjigjes.

Në përmbledhjen e gjerë të përgjigjeve të marra nga konsultimi, do të publikohet si një shtojcë në planin e menaxhimit të basenit ujqor final. Konsultimi për këtë dokument do të mbyllet më 8 Nëntor 2020.

Ky proces konsultimi po drejtohet nga AMBU si autoriteti përgjegjës në vend për hartimin e planeve të menaxhimit të baseneve ujore. Ky dokument është në përputhje me legjislacionin shqiptar për konsultimin me publikun, specifikisht nenet 15 dhe 17.

Nëse keni paqartësi mbi dokumentin apo mënyrën e përcjelljes së kontributit / opinionit, kontaktoni direkt:

Ermela Kraja, Përgjegjëse Sektori, Drejtorja e Burimeve Ujqore, AMBU.

Ermela.kraja@ambu.gov.al

2.4 Përmbledhje

Uji është themelor për jetën dhe mirëqënien. Ne në Shqipëri kemi shumë ponë për të bërë për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor. Qëllimi ynë është:

- Ujëra të brendshme dhe bregdetare të pastra nga ndotja dhe mbetjet e ngurta;
- Ekosisteme të shëndetshme dhe prurje ekologjike të garantuara për jetën e egër, që jeton brenda dhe rreth burimit ujor;
- Përdorim më efektiv, eficient dhe të qëndrueshëm të ujit si një burim natyror;
- Lumenj dhe liqene që janë të vlerësuara në aspektin e peisazhit urban dhe rural;
- Kontroll i aktiviteteve të paligjshme, sikurse shfrytëzimi i zhavorreve dhe hedhja e mbetjeve urbane, të cilat shkatërrojnë mjedisin e lumit.

Direktiva kuadër e ujit e BE-së ofron mundësi reale për të menaxhuar lumenjtë tanë sëbashku, më mirë dhe njëkohësisht duke marrë në konsideratë interesat e secilit prej nesh.

3. Basenet ujore të Ishmit dhe Erzenit

Nënseksionet e mëposhtme paraqesin një shpjegim të shkurtër të nënndarjeve të baseneve ujore të Ishmit dhe Erzenit në nënbasene më të vogla. Pritet që në Programin e Masave që do të zhvillohet për secilin basen mund të përfshihen objektiva dhe veprime të ndryshme specifike për secilin nënbasen, apo dhe për trupa ujorë individuale brenda këtyre nënbaseneve, në varësi të presioneve apo gjendjes së këtyre trupave ujorë, nivelit të ndikimit dhe realizueshmërisë së zgjidhjeve të efektshme gjatë periudhës së përfshirë në Plan.

3.1 Baseni ujor i lumit Ishëm

Nënbasenet janë renditur duke filluar nga rrjedha e sipërme në atë të poshtme.

3.1.1 Ishëm 4 (ISH4)

Nënbaseni ISH4 përbëhet nga burimet e lumit të Tiranës, i cili përshkon Parkun Kombëtar të Malit të Dajtit me kufi të rrjedhës së poshtme në Feraj, Tiranë. Terreni në këtë zonë është kryesisht rural dhe gjysëmmalor.

3.1.2 Ishëm 3 (ISH3)

Nënbaseni ISH3 përbëhet nga burimet e lumit të Tërkuzës me kufi të rrjedhës së poshtme në Digën dhe Rezervuarin e Bovillës. Terreni në këtë zonë është gjysëm rural dhe gjysëmmalor. Në shtrirjen e lumit të Tërkuzës thuajse deri në Fushë-Krujë, ka ndërhyrje të konsiderueshme për sa i përket sasisë dhe rrjedhës, si pasojë e Digës së Bovillës dhe furnizimit me ujë nga bashkia për Tiranën, i cili nxirret nga Rezervuari i Bovillës.

3.1.3 Ishëm 2 (ISH2)

Nënbaseni ISH2 përbëhet nga burimet e Lumit Zezë, i cili përshkon Parkun Kombëtar të Shtamës deri në fshatin Zezë. Terreni në këtë zonë është gjysëmrrural dhe gjysëmmlor.

3.1.4 Ishëm 1 (ISH1)

Nënbaseni ISH1 përbëhet nga burimet e lumit të Lanës dhe seksionet e ndërmjetme të lumit të Tiranës dhe Tërkuzës. Kufiri i tij krijohet nga bashkërrjedhja e lumit të Tiranës dhe Tërkuzës në Rinas, në pjesën veriore të aeroportit. ISH1 përshkon zonën urbane të qytetit të Tiranës.

3.1.5 Ishëm 0 (ISH0)

Nënbaseni ISH0 përbëhet nga rrjedha e poshtme e lumit Ishëm duke filluar nga seksioni i mesëm i basenit të bashkërrjedhjes së lumenjve të Tiranës dhe Tërkuzës deri në det. Në këtë nënbasen derdhet dhe ISH2, dhe përshkon zonat urbane dhe industriale të Krujës dhe Fushë-Krujës. Pjesa e ultësirës përbëhet kryesisht nga toka bujqësore dhe fusha aluviale/bregdetare përreth fshatit Thumanë.

3.2 Baseni ujqor i Erzenit

3.2.1 Erzen 4 (ERZ4)

Nënbaseni ERZ4 përbëhet nga një nënbasen i vogël i burimit të përroit Murdhar duke shkuar deri në Digën dhe hidrocentralin e Murdharit. Rrjedha e poshtme ka gjasa të jetë modifikuar në mënyrë të konsiderueshme për shkak të veprimtarisë së hidrocentralit. Terreni në këtë zonë është rural dhe gjysëmmlor.

3.2.2 Erzen 3 (ERZ3)

Nënbaseni ERZ3 përbëhet nga burimet e lumit Erzen dhe shtrihet deri në disa pjesë të peizazhit të mbrojtur të Malit me Gropa-Bizë-Martanesh. Terreni në këtë zonë është rural dhe gjysëmmlor. Kufiri i rrjedhës së poshtme formohet në daljen e Digës që përdoret për vaditje në rrjedhën e sipërme të grykës së Pëllumbasit. Rrjedha e ujit nga Diga devijohet nga një kanal i nivelit të lartë, i cili përdoret për vaditje.

3.2.3 Erzen 2 (ERZ2)

Nënbaseni ERZ2 përfshin seksionet e mesme të lumit Erzen nga Pëllumbasi deri në fshatin Fortuzaj, ku urbanizimi është më i lartë. Terreni në këtë zonë është kryesisht ultësirë dhe gjysmërrural, me hapësira të mëdha tokash bujqësore.

3.2.4 Erzen 1 (ERZ1)


Nënbaseni ERZ1 përfshin pjesët më të poshtme të lumit Erzen nga fshati Fortuzaj deri në det. Terreni në këtë zonë është kryesisht ultësirë, gjysmë i urbanizuar dhe me veprimtari të theksuar bujqësore. Ka gjasa që sistemet private të vaditjes të jenë të përhapura në masë

3.2.5 Erzen 0 (ERZO)

Teknikisht, nënbaseni ERZO është pjesë e basenit ujqor të Erzenit, por ka një zonë të ndarë derdhjeje. Ky nënbaseni karakterizohet nga ultësira bujqësore të shumta me sisteme kanalesh vaditëse, ku ndoshta një pjesë e ujit të përdorur nxirret nga lumi Erzen, por që kryesisht përdoren ujërat nëntokësore.

Nënbaseni përshkon zona të mëdha urbane të Kavajës dhe pjesës bregdetare të Durrësit.

Figura 3-2 – Vendndodhja dhe nënbasenet e basenit ujqor të Erzenit



Shkallë 1:300,000

46°00'00" 50°00'00"

Projekt bashkëpunueshet nga BE-ja dhe agjencitë Aq. H. dhe Aq. P. T. Shqipëri

4. Ndryshimet klimatike dhe burimet ujore

4.1 Rëndësia e kësaj tematike

Ndryshimet klimatike globale janë konsideruar si një nga kërcënimet kryesore në jetën e njerëzve dhe statusin ekologjik të planetit tonë. Emetimet e vazhdueshme të gazrave serë do të shkaktojnë ngrohje të mëtejshme në të gjithë komponentët të sistemit të klimës, duke rritur impaktin e pakthyeshem të përhershëm për njerëzit dhe ekosistemet. Kufizimi i ndryshimeve klimatike do të kërkonte reduktim thelbësor dhe të qëndrueshem të emetimeve të gazrave serë, të cilat së bashku me procesin e përshtatjes, mund të kufizojë riskun nga ndryshimet klimatike.¹

4.2 Situata aktuale

Në veçanti për Shqipërinë, janë përgatitur 3 komunikime zyrtare ² në kuadër të Konventës së UN për Ndryshimet Klimatike, e zbatuar kjo nga Ministria e Mjedisit dhe Programi për Zhvillimi i Kombeve të Bashkuara. Rritja e parashikuar e temperaturës dhe ulja e reshjeve janë ato çka priten të jenë prezente, sikurse tregohet në figurën 4-1.

Figure 4-1 – Projected Climate change Impacts 2025 - 2100

Scenarios for Albania		Time horizon		
		2025	2050	2100
Winter	temperature (°C)	0.8+1.0	1.3+1.8	2.1+3.7
	precipitation (%)	-1.6+0	-1.8+0	-3.7+0
Spring	temperature (°C)	0.7+0.9	1.0+1.5	1.8+3.0
	precipitation (%)	-2.7+-1.3	-3.6+-2.1	-7.4+-3.4
Summer	temperature (°C)	0.9+1.2	1.2+2.0	2.3+4.1
	precipitation (%)	-8.0+-5.6	-20.0+-9.1	-27.0~-14.4
Autumn	temperature (°C)	0.9+1.1	1.1+2.0	2.1+3.8
	precipitation (%)	-4.3+-3.4	-11.2+-2.1	-16.2+-8.6
Annual	temperature (°C)	0.8+1.0	1.2+1.8	2.1+3.6
	precipitation (%)	-3.8+-2.4	-6.1+-3.8	-12.5+-6.0
Sea level (cm)			20-24	48-61
Cloud cover (%)		-1.3+-1.5	-2.6+-2.0	-4.6+-3.1
Wind speed (%)		0.7	1+1.3	1.6+2.3

Burimi: 1st National Communication of the Republic of Albania on Climate Change

Për shkak të kolapsit të sistemit të monitorimit të prurjeve sipërfaqësore, që nga viti 2000 (shiko seksionin 5), AMBU aktualisht nuk është në gjendje të llogarisë saktësisht sasinë

¹ Inter-Governmental Panel on Climate Change (IPCC) 2014 – Climate Change 2014 – Synthesis Report, p8


² 1st (2002), 2nd (2009), 3rd (2016) National Communication of the Republic of Albania on Climate change

vjetore të reshjeve dhe ndryshimet e disponueshmërisë së burimeve ujore për periudhën 1991-2020.

Në aspektin e emergjencës klimatike, e cila aktualisht ka marrë një vëmendje nga shkencëtarët e mëdhenj botërorë³, është shumë e rëndësishme që autoritetet kombëtare shqiptare (specifikisht AMBU, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, IGJEUM) të koordinojnë sëbashku për identifikimin e saktë të trendit aktual dhe ndryshimeve në burimet ujore, në nivel baseni ujqor. Kjo kërkon të dhëna të përditësuara hidrometereologjike për t'u grumbulluar dhe analizuar, si dhe për t'u krahasuar me të dhënat e besueshme historike.

Europa Jugore, në mënyrë të përsëritur, është identifikuar në Raportet e IPCC si një vend me ndjeshmëri të veçantë për burimet ujore ndaj impaktit të ndryshimeve klimatike, ku risku vlerësohet nga mesatar në të lartë, pra, nivel i ulët të përshtatjes⁴.

Figure 4-2 – Indications of Climate Change Impacts for Southern Europe



Source: IPCC 5th Assessment Report, Working Group II, 2014

4.3 Ndërlikimet dhe nevojat e ardhshme

Rritja e temperaturave dhe reduktimi i reshjeve mund të ketë një influencë të madhe në sasinë e burimeve ujore vjetore në basen brenda 30-50 vjetëve.

Me reduktimin e prurjes së ujërave sipërfaqësore dhe rritjen e evaporimit, uji i grumbulluar çdo vit në rezervuare gjithashtu do të ulet, çka nënkupton se më pak ujë për njerëz, për HEC-et dhe bujqësinë, specifikisht gjatë muajve kritik të verës (të thatë). Ujërat nëntokësore do të ndikohen nga ulja e përshkrueshmërisë së ujërave sipërfaqësore, për shkak të uljes së sasisë së reshjeve, rrëkeve sipërfaqësore dhe humbjeve të lagështirës së tokës nga rritja e evapotranspirimit.

Reduktimi i ujërave nëntokësore i kombinuar me rritjen e mundshme të kripësisë së tyre për shkak të rritjes së nivelit të ujit të detit mund të sjellë dobësim të cilësisë së ujit të pijshëm aty ku ujërat nëntokësore janë burim parësor furnizimi, për shembull në zonat bregdetare.

³ BioScience, 2019, Vol. XX No. X, "World Scientists' Warning of a Climate Emergency"

⁴ IPCC AR5 – Working Group II - Impacts, Adaptation and Vulnerability, March 2014

Autoritetet përgjegjëse për monitorimin e hidrometereologjisë duhet urgjentisht të përmirësojnë disponueshmërinë dhe gamën e të dhënave të lidhura me ndryshimet klimatike, për të përmirësuar kështu vërtetësinë e vlerësimeve lokale.

4.4 Masat e mundshme për zbatim brenda planit të menaxhimit të basenit ujor

Tabela 4-1 –veprimet e mundshme për Programin e Masave

Ndryshimet klimatike dhe burimet ujore	
Problematika të mundshme	Reagimi i nivelit drejtues për adresimin e problematikës
Nevoja për të përcaktuar nëse ndryshimet klimatike kanë reduktuar ndjeshëm sasinë e reshjeve dhe burimet ujore në basenet ujore Ishëm dhe Erzen për periudhën 1960-2018.	Koordinoni një studim teknik me IGJEUM-in për të llogaritur tendencat afatgjata të sasisë së reshjeve në nivel vendor. Përcaktoni sasinë mesatare të reshjeve vjetore për periudhën 1961-1990 kundrejt periudhës 1991-2020. Përgatitni bilance të përditësuara dhe të vlefshme të ujit në nivel nënbaseni
Monitorimi hidrometereologjik në basene ujore duhet të përmirësohet urgjentisht. Të dhëna të pamjaftueshme për lartësi > 800m.	Buxhet i mjaftueshëm dhe burime njerëzore duhet të vihen në dispozicion të IGJEUM për të përmirësuar monitorimin e reshjeve në basenet ujore. Cilësia dhe disponueshmëria e të dhënave të vëna në dispozicion nga palët e interesit duhet të përmirësohet urgjentisht.

5. Sistemet e monitorimit hidrometeorologjik dhe sistemet e të dhënave

5.1 Rëndësia e kësaj tematike

Në mungesë të monitorimi të mjedisit, AMBU nuk është në gjendje të kryejë vlerësime mbi disponueshmërinë e burimeve ujore apo të përcaktojë nëse këto burime janë apo jo nën presion (për shembull mbishfrytëzimi).

Matjet dhe menaxhimi i sasisë së ujit është shumë i rëndësishëm për përdorimin afat – gjatë të ujit. Matja e saktë e reshjeve dhe shkarkimet e ujërave në basen ujor janë elementë thelbësore në matjen dhe menaxhimin e prurjeve sipërfaqësore dhe nëntokësore, si dhe vlerësimin e impaktit të ndryshimeve klimatike. Përcaktimi korrekt i prurjes mjedisore varet nga matja historike e nivelit të prurjeve.

5.2 Situata aktuale

Nga eksperiencën, por dhe nga raportet teknike^{5 6}, rrjeti kombëtar hidrometeorologjik është në gjendje kolapsi për shkak të mungesës së buxhetit, stafit dhe burimeve. 50% e 102 stacioneve kombëtare të monitorimit meteorologjik janë jashtë funksioni për sa i përket matjes së temperaturave dhe reshjeve, me gabime të mëdha në matje apo mungesë totale të matjeve. Vetëm 22% e stacioneve meteorologjike në Shqipëri janë të pajisur për matjen e reshjeve të borës, edhe pse ky është një element thelbësor për mbushjen e burimeve ujore gjatë stinës së dimrit dhe pranverës.

Autoriteti përgjegjës për monitorimin hidrometeorologjik në basenet ujore është IGJEUM, por gjithashtu edhe Shërbimi Ushtarak Meteorologjik operon me 13 stacione të pavarurara të parashikimit të motit, të cilat besohet se janë në gjendje më të mirë operimi.

Aktualisht, në këto basenin ujore nuk ka evidenca të një stacioni funksional hidrometrik për matjen e nivelit të prurjeve. Historikisht është besuar që janë 7 stacione monitorimi në Ishëm dhe 4 në Erzen.

Të dhënat e kërkuara për këto stacione monitorimi nga IGJEUM, janë vënë në dispozicion për periudhën 1960/70-1992. Përrjashtim bën vetëm stacioni Ndroq në lumin Erzen, ku të dhënat datojnë në vitin 2004. Pas vitit 1992 nuk raportohen të dhëna funksionale për shumicën e stacioneve hidrometrike në Shqipëri.

Si pjesë e grupit teknik për hartimin e këtij dokumenti, Universiteti i Tiranës (FSHN) ka identifikuar mungesën e madhe të koordinimit dhe transparencës në shpërndarjen e përgjegjësive, në lidhje me ndryshimet klimatike dhe analizat e të dhënave meteorologjike në përgjithësi, si dhe mungesë e stafit të nevojshëm, burimeve dhe fondeve. Procedurat e

⁵ World Bank (2015) - On The Establishment Of Institutional And Regulatory Platform For Governance And Functioning (Irp) Of The National Water Resources Cadastre In Albania

⁶ World Meteorological organisation (WMO) (2019) - Report on the Quality Control and Homogenization of climate data from Albania for the PRO NEWS project

monitorimit të ndikimit të ndryshimeve klimatike mbi hidrometereologjinë ende nuk janë identifikuar.

5.3 Ndërlikimet dhe nevojat e ardhshme

Dështimi i rrjetit hidrometereologjik do të thotë që nuk mund të realizohet identifikimi i saktë i burimeve ujorë në basen, duke nënvlerësuar rëndësinë dhe nevojën për të pasur një plan menaxhimi.

Në veçanti:

- Strategjia për menaxhimin e burimeve ujore në nivel baseni (*për të përcaktuar balancën ujore të basenit ujqor, burimet në dispozicion, mbushja e burimeve sipërfaqësore dhe nëntokësore*) nuk mund të kryhet;
- Plani i menaxhimit të riskut nga përmybtja, në nivel baseni ujqor, nuk mund të përgatitet në përputhje me Direktivën 2007/60/EC⁷;
- Plani i menaxhimit të riskut nga thatësiat nuk mund të përgatitet në përputhje me Udhëzimet e BE-së;
- Statusi ekologjik i trupave ujqor në basenin ujqor (*të cilat varen në mënyrë kritike nga regjimi i prurjes*) nuk mund të përcaktohet saktë në përputhje me Direktivën 2000/60/EC⁸.

Kolapsi i sistemit të monitorimit hidrometereologjik (ku burimet ujore nuk janë matur dhe analizuar saktë për rreth 30 vite) ngre pyetje të mëdha për AMBU, e cila nuk është në gjendje të kryejë rolin e tij kryesor të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve ujore dhe shpërndarja e ujit në sektorë.

Me shumë mundësi është e nevojshme një riorganizim institucional i mënyrës se si grumbullohen dhe analizohen të dhënat hidrometereologjike dhe se si ato vihen në dispozicion të agjencive kombëtare apo institucioneve profesionale. Vlerësimi sasior dhe kuptimi i qartë i burimeve ujore varet totalisht nga saktësia dhe besueshmëria e të dhënave, ndaj rrjeti i stacioneve hidrometereologjike duhet të konsiderohet si një çështje me rëndësi kombëtare.

Reshjet mujore dhe të dhënat e nivelit të prurjeve duhet në mënyrë të vazhdueshme të vihen në dispozicion të palëve të interesit nëpërmjet një sistemi online, sikurse Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujqore, çka aktualisht nuk zbatohet.

⁷ European Commission Directive 2007/60/EC on the assessment and management of flood risks

⁸ European Commission Directive 2000/60/EC Water Framework Directive

5.4 Masat e mundshme për zbatim brenda planit të menaxhimit të basenit uJOR

Tabela 5-1 – veprimet e mundshme për Programin e Masave

5 - SISTEMET E MONITORIMIT HIDROMETEOROLOGJIK DHE SISTEMET E TË DHËNAVE	
Problematika të mundshme	Reagimi i nivelit drejtues për adresimin e problematikës
Vështirësi në marrjen e të dhënave të vlefshme për rrjedhën nga Instituti i Gjeoshkencave (IGJEU)	Krijoni një Memorandum Mirëkuptimi për të ofruar rregullisht të dhëna për cilësinë (niveli i reshjeve, rrjedhës, ujërave nëntokësore) në formën e të dhënave të përmbledhura, p.sh.: 6-mujore Të dhëna të përmbledhura (mesatare mujore) që do të ruhen në kadastrën e ujit
Mosfunksionim i mundshëm i pjesës dërrmuese të sistemit për monitorimin e rrjedhës në basenin uJOR që prej vitit 1990 për shkak të mungesës së stafit dhe të burimeve. Sasia e ujit dhe burimet ujore, si dhe uji i disponueshëm për përdorim nuk mund të përcaktohet për asnjë trup uJOR.	Kërkohet një ndryshim madhor në strukturë për përgjegjësinë dhe ofrimin e këtij shërbimi kritik kombëtar. <ul style="list-style-type: none"> • Ngrini problematikën në nivelin më të lartë politik • Financoni mjaftueshëm divizionin e duhur • Ringarkojani një përgjegjësinë e monitorimit të rrjedhës agjencie të përshtatshme alternative, si p.sh. Ministrisë së Mjedisit
Nuk ka të dhëna mbi prurjen në lumenj që nga viti 1992. Vlerësimet aktuale të menaxhimit bazohet në të dhëna 28 vjeçare. Llogaritjet aktuale të ndryshimeve klimatike, burimeve dhe prurjeve mjedisore janë të pakuptimta.	Duhet urgjentisht të rivihen në funksion stacionet e matjes së prurjeve dhe të operohën nga një Agjenci kombëtare.
Statusi ekologjik i trupave ujore nuk mund të përcaktohet plotësisht pasi prurja është një element kritik i statusit në Direktivën 2000/60/EC.	Duhet urgjentisht të rivihen në funksion stacionet e matjes së prurjeve dhe të operohën nga një Agjenci kombëtare.

6. Zonat e mbrojtura dhe Ekosistemet ujore

6.1 Rëndësia e kësaj tematike

Referuar legjislacionit europian, zona e mbrojtur është një zonë gjeografike e mirëpërcaktuar, dedikuar ruajtjes afat-gjatë të natyrës. Kategoritë e menaxhimit të zonave të mbrojtura IUCN i klasifikojnë ato sipas objektivave të menaxhimit.⁹

Rrjeti i "Natura 2000" u krijua në nivelin e BE-së nëpërmjet Direktivës së Zogjve dhe atë të Habitaveve. Qëllimi primar i saj është sigurimi i objektivave të ruajtjes së specieve dhe habitateve me interes Europian¹⁰. Rrjeti i BE-së Emerald është një rrjet ekologjik i krijuar nga zonat me interes të veçantë të ruajtjes. Objektiv i është mbijetesa afat-gjatë e specieve dhe habitateve të Konventës së Bernës, të cilat kërkojnë masa specifike të mbrojtjes¹¹.

Në kuadrin e Direktivës kuadër të ujit të BE-së (Shtojca VII) "zonat e mbrojtura" gjithashtu përfshin:

- Zonat e identifikuar për nxjerrjen e ujit të pijshëm;
- Zonat e identifikuar për mbrojtjen e specieve ujore me rëndësi ekonomike;
- Trupat ujorë të identifikuar si ujëra për rekreacion, përfshi zonat e identifikuar si ujëra të larjes sipas Direktivës 76/160/EEC;
- Zonat e ndjeshme ndaj nitrateve, përfshi zonat e identifikuar si vulnerabël sipas Direktivës 91/676/EEC dhe zonat e identifikuar si sensitive sipas Direktivës 91/271/EEC;
- Zonat e identifikuar për mbrojtjen e habitateve ose specieve ku kërkohet mirëmbajtja ose përmirësimi i statusit të ujit si një faktor i rëndësishëm për mbrojtjen e tyre, përfshi zonat relevante "Natura 2000" të identifikuar sipas Direktivës 92/43/EEC dhe Direktivës 79/409/EEC.

6.2 Situata aktuale

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) është autoriteti përgjegjës për menaxhimin e sistemit të zonave të mbrojtura në Shqipëri. Puna për menaxhimin e zonave Natura 2000 ka nisur vetëm sëfundit¹². Qeveria shqiptare në vitin 2019 ka përcjellë 25 zona kandidate për t'u pëfshirë në rrjetin Emerald, të cilat u miratuan me kusht.

Figura 6-1 tregon zonat e mbrojtura primare në këtë basen ujor, specifikisht parku kombëtar Dajt (16) dhe rezervat natyrore bregdetare në jug dhe veri Durrës (41) (42). Zona të tjera të mbrojtura, përfshijnë parkun kombëtar Qafshatama, peisazhi Mali me gropa-Bize-Martanesh dhe rezervatet e menaxhuara Rrushkull dhe Patok-Fushë-kuqe Ishëm.

⁹ <https://www.iucn.org/theme/protected-areas/about/protected-area-categories>

¹⁰ European Commission - https://ec.europa.eu/environment/nature/natura2000/index_en.htm

¹¹ Council of Europe - <https://www.coe.int/en/web/bern-convention/emerald-network>

¹² EU - Strengthening National Capacity In Nature Protection – Preparation For Natura 2000 Network, March 2019

Figure 6-1 – Protected Areas Network Ishem-Erzen Region



Sistemi shqiptar i zonave të mbrojtura po has sfida të mëdha të shkaktuara nga niveli i ulët i investimeve infrastrukturore në zonat e mbrojtura, mungesa e pajisjeve dhe nevoja për rritjen e kapaciteteve teknike të stafit. Rugët e reja dhe infrastruktura, digat, HEC-et, rezervuarët e naftës dhe infrastruktura e turizmit masiv krijon kërcënime serioze në mbrojtjen e mjedisit.

6.3 Ndërlikimet dhe nevojat e ardhshme

Mungesa e përgjithshme e identifikimit dhe mbrojtjes së zonave higjieno-sanitare përbën një shqetësim të veçantë për AMBU dhe ERRU. Kjo përfshin nën-basenin uhor që shkarkon në rezervuarin e Bovillës, i cili furnizon me ujë të pijshëm një pjesë të mirë të qytetit të Tiranës. Ka një nevojë urgjente për të identifikuar dhe hartëzuar zonat e mbrojtjes për burimet ujore nëntokësore të përdorura për furnizim të ujë të pijshëm.

Së dyti, ato ekosisteme ujore, në të cilat prurja mjedisore ose kushtet morfologjike janë kritike për statusin ekologjik të trupave ujore brenda zonave të mbrojtura, nuk janë identifikuar plotësisht. Kjo përfshin ujërat nëntokësore të varura nga ekosistemet.

Ka një nevojë urgjente për të llogaritur regjimin e prurjes mjedisore saktësisht në këto zona specifike, të forcohen këto prurje dhe gjithashtu të ndalohet shkatërrimi i habitateteve dhe ekosisteme ujore, si dhe të ndalohet vazhdimësia e aktiviteteve të paligjshme për aktivitetin minerar dhe zhavorret (Universiteti i Tiranës, FSHN).

Monitorimi i trupave ujore dhe procedura standarte kombëtare për identifikimin e kushteve biologjike të referencës janë të nevojshme për statusin ekologjik të trupave ujore. Këto mund të realizohen për të përmbushur kriteret e Direktivës 2000/60/EC.

6.4 Masat e mundshme për zbatim brenda planit të menaxhimit të basenit ujqor

Tabela 6-1 – veprimet e mundshme për Programin e Masave

6 - ZONAT E MBROJTURA DHE EKOSISTEMET UJORE	
Problematika të mundshme	Reagimi i nivelit drejtues për adresimin e problematikës
Risku afat-shkurtër për ujërat nëntokësore të pijshme nga zhvillimi i pakontrolluar urban	AMBU të punojë me SHGJSH për të identifikuar dhe hartëzuar zonat e mbrojtura zyrtare për ujërat nëntokësore të cilat duhet të jenë pjesë e kuadrit të planifikimit urban.
Risku afat-gjatë në ujërat nëntokësore të pijshme nga zhvillimi i pakontrolluar urban dhe rural, përfshi aplikimin pa kontroll të plehëruesve.	AMBU të punojë me SHGJSH për të identifikuar dhe hartëzuar zonat e mbrojtura zyrtare për ujërat nëntokësore të cilat duhet të jenë pjesë e kuadrit të planifikimit urban.
Risku për zonat me rëndësi specifike, speciet endemike dhe ekosistemet ujore pa identifikuar si duhet trupat ujore me vlera ekologjike.	AMBU dhe AKZM të koordinojnë monitorimin dhe hartëzimin e zonave me rëndësi ekologjike, për të vlerësuar në sasi dhe reduktuar presionet dhe për të identifikuar zonat e mbrojtjes për këto trupa ujqorë.
Kushtet biologjike të referencës për trupat ujore nuk është kryer si duhet për shumicën e trupave ujore në Shqipëri. Statusi ekologjik i të gjitha trupave ujore aktualisht nuk po përcaktohet sipas Direktivës 2000/60/EC.	AMBU dhe AKM të koordinojnë për monitorimin dhe zhvillimin e procedurave kombëtare standarte për përcaktimin e kushteve të referencës për trupat ujore standarte tipike në Shqipëri.

7. Përmbytjet dhe thatësitrat

7.1 Rëndësia e kësaj tematike

Ndonëse përmbytjet dhe thatësitrat janë fenomene jo të shpeshta, parashikimet e IPCC për ndryshimet klimatike tregojnë botërisht se frekuenca dhe intensiteti i tyre do të rritet në të ardhmen¹³. Dekadat në vazhdim pritet që të përballen me një risk më të lartë të përmbytjeve në Europë dhe dëme më të dhëma ekonomike.

Përmbytje të mëdha janë shfaqur në Shqipëri, në nivel lokal dhe rajonal, në vitet e fundit. Këto përmbytje kanë ndikuar në jetën e mijëra, si dhe kanë shkaktuar dëme të mëdha ekonomike, veçanërisht në zonat urbane.

Në vijim të dëmeve ekonomike dhe sociale, përmbytjet kanë gjithashtu edhe dëme mjedisore, për shembull kur instalimet industriale përmbajnë kimikate toksike apo produkte naftë dhe ato dëmtohen nga përmbytjet.

Periudhat e thatësirave kanë ndikim të dukshëm në prodhimin bujqësor, duke krijuar vështirësi ekonomike për fermerët, por gjithashtu ndikojnë edhe në furnizimin me ujë të pijshëm. Pakësimi i ujit dhe thatësitrat janë një fenomen i shtuar dhe shumë i përhapur në BE. Mungesa e balancës afat-gjatë, si rezultat i rritjes së kërkesës për ujë, përtej burimeve ujore në dispozicion, nuk është më një problem i izoluar.

7.2 Situata aktuale

Në basenet ujore Ishëm dhe Erzen përmbytje të mëdha kanë ndodhur në vitin 2012 (Durrës, Lezhë. 2010 (Lezhë, Durrës), 2016 (Durrës), dhe 2018 (Fushë-Krujë). Argjinaturat e lumenjtë të lëna pas dore, reduktimi i kapaciteteve të stacioneve të pompimit, shkëputjet e energjisë elektrike për pompat apo zhvillimi i pakontrolluar urban në zonat e ndjeshme, të ulëta, ndikuar në përkeqësimin e këtij problemi. Gjithashtu, në këto periudha të mëdha përmbytjesh janë raportuar edhe probleme sanitare (me higjenën) apo furnizimin me ujë të pijshëm.

Si pjesë e grupit teknik të konsultimit të këtij dokumenti, Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen Civile (AKMC) ka raportuar dëme shumë të mëdha në tokat bujqësore në zonën e Bubqit dhe në Shijak, në pjesën e poshtme të basenin të lumit Erzen. Mungesa e ndërhyrjeve nga bashkitë, mungesa e burimeve financiare dhe skemat e planifimit janë cituar nga kjo agjenci si pengesa në menaxhimin efektiv të përmbytjeve.

Sfida kryesore nga pakësimi i ujit dhe thatësitrat në BE janë zyrtarisht të përmendura edhe në Komunikimin " "Addressing the challenge of water scarcity and droughts" (*Adresimi i sfidës së mungesës së ujit dhe thatësirave*) nga BE e miratuar në 2007 (COM2007)414).

Mungesat e ujit dhe keqmenaxhimi i ujit të pijshëm (për shembull humjet e mëdha, lidhjet e paligjshme) janë të përhapura në të gjithë vendin si probleme, por veçanërisht në Tiranë, e cila mbështetet kryesisht në burimet ujore sipërfaqësore nga rezervuari i Bovillës. Referuar

¹³ Inter-Governmental Panel on Climate Change (IPCC) 2014 – Climate Change 2014 – Synthesis Report

të dhënave metereologjike (stacioni Dajt), thatësira shumë të mëdha janë shfaqur në vitet 1991, 1994, 1997, 2003, 2007, 2008, 2011 dhe 2015. Si pasojë, reduktimi i dukshëm i reshjeve (mundësisht i shoqëruar nga mungesa e burimeve ujore) ndodh me një probabilitet vjetor prej 23%, ose 1 në 5 vjet mesatarisht.

Duke qënë se, presioni i popullsisë dhe kërkesa ekonomike, përgjithësisht krijojnë kërkesë në rritje për ujë në momentin kur burimet ujore janë në rënie, përgatitja e planeve për të menaxhuar thatësitat në të ardhmen përbën një kërkesë urgjente.

7.3 Ndërlikimet dhe nevojat e ardhshme

Mbrojtja dhe zbutja e përmbytjeve është një problematikë e madhe brenda BE-së. Për këtë arsye, Direktiva 2007/60/EC krijon një kuadër për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga përmbytja për të reduktuar kështu pasojat negative në shëndetin njerëzor, aktivitetet ekonomike, mjedisin dhe trashëgiminë kulturore. Kuadri për menaxhimin e riskut nga përmbytja duhet të jetë pjesë e planit të menaxhimit të basenit ujor. Praktikisht kjo nënkupton që skemat dhe propozimet e planifikuara si pjesë e strategjisë për menaxhimin e përmbytjeve nuk duhet të nënvlerësojnë objektivat mjedisore të planit të menaxhimit të basenit ujor.

Përgatitja e planit paraprak të vlerësimit të riskut nga përmbytja është një kërkesë për të gjitha vendet e BE-së bazuar në informacionin në dispozicion (neni 4) të përmbytjeve të cilat kanë ndodhur në të shkuarën si dhe të identifikojë pasojat potencialisht të pakthyeshme për përmbytjet në të ardhmen. Për "zonat me risk potencialisht sinjifikativ të përmbytjes" nevojitet përgatitja e një plani menaxhimi të riskut nga përmbytja.

Aktualisht AMBU po përgatit hartat e rrezikut nga përmbytja për disa zona të përzgjedhura në disa basene ujore në të gjithë vendin në kuadër të zbatimit të projektit "Pro News", i financuar nga BE. Mungesa e të dhënave hidrometereologjike nga institucione të ndryshme (psh, IGJEUM) përbën një problem kritik për hartimin e një plani të saktë për përmbytjet dhe thatësitat.

Praktikat më të mira globale tregojnë që për zonat ujore me mungesa uji, duhet të menaxhohen nëpërmjet planeve respektive për menaxhimin e riskut nga thatësitat¹⁴ ¹⁵. Brenda këtyre planeve, reduktimi i humbjeve nga sistemet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe rritja e eficiencës së ujit në bujqësi janë problematika kritike për të luftuar pakësimin e ujit¹⁶.

Sikurse në rastin e përmbytjeve, AMBU nuk ka përgatitur apo ka bashkëpunuar me palët e interesit për shembull UK Tiranë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për përgatitjen e planeve të menaxhimit të thatësirave në Shqipëri.

¹⁴ Global Water Partnership - Guidelines for preparation of the Drought Management Plans, 2015

¹⁵ ISDR - Drought Risk Reduction Framework and Practices, United Nations, 2009

¹⁶ Water scarcity and Droughts in the European Union - Third Follow up Report to the Communication on water scarcity and droughts in the European Union COM (2007) 414, 2010

Në veçanti, ka një nevojë urgjente për të përgatitur planin e menaxhimit të riskut nga thatësitat për UK Tirana, ku mbishfrytëzimi i ujërave ka mundësi të ndodhë si rezultat i rritjeve të propozuar në kapacitetit e shpërndarjes nga rezervuari i Bovillës.

7.4 Masat e mundshme për zbatim brenda planit të menaxhimit të basenit ujq

Tabela 7-1 – veprimet e mundshme për Programin e Masave

7- PËRMBYTJET DHE THATËSIRAT	
Problematika të mundshme	Reagimi i nivelit drejtues për adresimin e problematikës
Përmbytjet historike të zonave urbane dhe rurale është një problematikë e gjerë në prefektuar Durrës dhe Fushë-Krujë.	Vlerësimet paraprake të riskut nga përmbytja duhet të përgatiten për zonat e përmbytshme të njohura. Planet e menaxhimit të riskut nga përmbytja duhet të përgatiten për ato zona që janë me risk potencial të lartë për tu përmbytur.
Mungesa e të dhënave të fundit hidrometereologjike do të pengojë analizimin e saktë të shkaqeve dhe zgjidhjet për fenomenet e përmbytjeve dhe thatësirave.	Monitorimi i nivelit të prurjeve në lumenjtë Ishëm dhe Erzen duhet urgjentisht të matet për të përgatitur kështu edhe llogaritjet për burimet ujore aktuale.
Rritja e kërkesave për qytetin e Tiranës për ujë, dhe nivelet e larta të konsumit dhe humbjet.	Identifikimi i nevojave për të dhëna dhe përgatitja e planit të menaxhimit të riskut nga thatësitat për Tiranën.

8. Morfologjia dhe vijimësia e kanaleve dhe lymishtave

8.1 Rëndësia e kësaj tematike

Ndërhyrja ose shkatërrimin e habitateve ujore nëpërmjet kanalizimeve dhe ndryshimet e zonave të përmytura, kanë një ndikim shumë të madh në speciet ujore dhe të ashtuquajturat “shërbimet e ekosistemit”. Shërbimet e ekosistemit janë kontribues direkt / indirekt të ekosistemeve në mirëqënien e njerëzve.

Shembuj konkret përfshijnë dëmtimin direkt në ekosistemet ujore nëpërmjet aktivitetit minerar pa kontroll, barrierat e peshkut dhe hedhja e vezëve të peshkut dhe ato të migrimit, ndjekur nga ndërtimi i barrierave, digave, argjinaturave, kanalizimet e lumenjve, si rezultat i urbanizimit dhe ndarja e zonës së përmytshme natyrore nga korridori i lumit si rezultat i skemave të mbrojtjes nga përmytja. Të gjitha këto aktivitete ndikojnë në cilësinë e ekosistemeve ujore dhe në qëndrueshmërinë e tyre.

8.2 Situata aktuale

Në Shqipëri ka një neglizhencë të gjerë sa i përket efekteve të dëmshme nga ndërhyrjet në morfologjinë dhe vazhdimësinë e lumenjve. Shumë skema janë lejuar të ndërtohen pa kryer një vlerësim të plotë të ndikimit në mjedis. Diga dhe barrierat janë ndërtuar pa konsideruar rrugët e kalimit të peshqve apo vazhdimësinë e habitateve. Marrja e zhavorreve është aktivitet i paligjshëm, pasi zbatimi i legjislacionit nuk ndodh. Argjinaturat e mbrojtjes nga përmytja dhe aktiviteteve të tjera në brigje e ndajnë kanalin nga shtrati natyror i zonës së përmytshme.

Figure 8-1 – Gravel Mining and Destroyed Habitat on the Terkuza Stream



Në veçanti, shpërndarja e gjerë e HEC-eve të vogla në Shqipëri pa një kontroll të mjaftueshëm të ndikimeve dhe prurjeve, po dëmton ekosistemet ujore.

8.3 Ndërlikimet dhe nevojat e ardhshme

Ekosistemet mirëmbajnë prurjet dhe furnizimin më ujë, rregullojnë cilësinë e ujit, dhe reduktojnë fatkeqësitë natyrore të lidhura me ujin. Ekosistemet ujore sigurojnë burimet natyrore, për shembull peshqit, blektorinë, dhe prodhimet pyjore, duke mbështetur një gamë të gjerë prodhimesh dhe konsumi, të cilat shpesh përfaqësojnë një vlerë ekonomike të lartë por që është e keqkuptuar dhe rrallë e artikuluar. Si pasojë, shpesh këto anashkalohen gjatë vendimarrjeve, duke çuar në mungesë të fondeve dhe mungesë të ujit për ekosisteme. Rrjedhimisht, këto ekosisteme e humbasin vlerën e tyre ekonomike pasi janë degraduar dhe shkatërruar ¹⁷.

Aktualisht, nuk ka një inventar kombëtar të zonave specifike me rëndësi ekologjike ujore e mbajtur nga AMBU apo AKZM.

AMBU ka një nevojë prioritare të bashkëpunojë në konsultim me AKZM për të identifikuar dhe hartëzuar të gjitha trupat ujorë të shoqëruara me zonat e mbrojtjes specifike (Direktiva 2009/147/EC), zonat e veçanta të ruajtjes (Direktiva 92/43/EEC) ¹⁸ dhe të identifikojë presionet dhe statusin aktual ekologjik për këto trupa ujorë. Kjo përfshin specifikisht mbrojtjen e ujërave nëntokësore të varura nga ekosistemet, që është një objektivi mjedisor në zbatim të Direktivës kuadër të ujit.

Figure 8-2 – Channelisation of the Erzen River and Disrupted Morphology



¹⁷ International Union for Conservation of Nature and Natural Resources (IUCN) - Counting Ecosystems as an Economic Part of Water Infrastructure, 2004

¹⁸ https://ec.europa.eu/environment/nature/natura2000/sites/index_en.htm

8.4 Masat e mundshme për zbatim brenda planit të menaxhimit të basenit ujor

Tabela 8-1 – veprimet e mundshme për Programin e Masave

8 - MORFOLOGJIA DHE VIJIMËSIA E KANALEVE DHE LYMISHTAVE	
Problematika të mundshme	Reagimi i nivelit drejtues për adresimin e problematikës
<i>Mungesa e publikimit të hartave treguese të trupave ujore më status të veçantë ekologjik</i>	<i>AMBU të koordinojë me AKZM për të hartëzuar trupat ujore specifike dhe identifikojë ato që shoqërohen me vlerat specifike ekologjike. Kushtet e references duhet të identifikohen për këto trupa ujore.</i>
<i>Trupat ujore tepër të modifikuar janë një tip i veçantë i trupave ujorë sipas Direktivës kuadër të ujit. Këto duhet të identifikohen.</i>	<i>AMBU duhet të identifikojë të gjitha trupat ujorë tepër të modifikuar dhe propozojë masa për përmirësimin e potencialit ekologjik të tyre.</i>

9. Prurja ekologjike

9.1 Rëndësia e kësaj tematike

Evidenca të shumta kanë treguar se regjimi i prurjes së shumë lumenjve (të vegjël a të mëdhenj) luan një rol primar në strukturën dhe funksionimin e ekosistemeve ujore. Virtualisht të gjithë lumenjtë, liqenet, lagunat dhe ujërat nëntokësore janë gjerësisht të kontrolluara nga regjimi hidrologjik¹⁹. Ndryshimi i origjinës dhe sasia e prurjes së ujërave në një lum, përgjatë një viti tipik siguron habitatin dhe influencën në mënyrë të dukshme cilësinë e ujit, temperaturën, ciklin e nutrientëve, disponueshmërinë e oksigjenit dhe proceset gjeomorfike, të cilat formëzojnë kanalet e lumenjve dhe zonat e përmblyshme.

Në kundërshtim me praktikën aktuale në Shqipëri dhe vende të tjera në Europë, “prurja ekologjike” nuk është një vlerë e vetme minimale, e cila duhet të ruhet në një kanal të lumit. Në fakt prurja ekologjike e tejkalon të gjithë vargun e plotë, kohor dhe ndryshueshmërinë e të gjitha prurjeve natyrore përgjatë vitit²⁰. Kur regjimi natyror ndryshon, për shembull nëpërmjet devijimit të prurjes për ndërtimin e HEC-eve, ose të niveleve të tejkaluara të nxjerrjes së ujit për ujë apo ujë të pijshëm, regjimi i ndryshuar pritet të ketë ndikim dëmtes, të dukshëm në ekosistemet ujore, duke reduktuar statusin ekologjik të trupave ujore në më pak se të “mirë”. Ky koncept përbën objektivin mjedisor kryesor i Direktivës kuadër të ujit.

9.2 Situata aktuale

Prurjet ekologjike aktualisht, nuk janë kuptuar mirë në Shqipëri dhe metodat aktuale për llogaritjen e saj janë shumë të vjetëruara dhe jo koherente me praktikën më të mira të fundit ndërkombëtare. Është pothuajse e sigurtë që “prurja e ekologjike minimale”, e përshkruar në ligjin për ujërat²¹, bazuar në prurjen që është e barazvlefshme me 355 ditë të vitit (Q₃₅₅) është e pamjaftueshme për mbrojtjen e ekostimeve ujore, dhe në çdo rast është një koncept jo i drejtë.

Shumë HEC-e, përgjatë vendit, vazhdojnë të miratohen bazuar në këto kritere, potencialisht duke lejuar të gjitha prurjet mbi këtë minimum limit për shfrytëzim dhe devijim. Instalimet e HEC-eve janë veçanërisht dëmtes ndaj prurjes ekologjike nëpërmjet a) mbishfrytëzimit ose sasisë e devijuara në peridua kritike b) rritja jo e drejtë në prurje mbi kushtet e regjimit natyror për shkak të pikut ujqor nga turbinat²².

Diga e Bovillës (lumi Tërkuzës) dhe ajo e Murdharit (përroi Murdharit) janë ndërtuar të dy që nga viti 1998, duke krijuar barriera të mëdha në ekosistemet lokale pa asnjë masë për

¹⁹ European Commission - Ecological flows in the implementation of the Water Framework Directive, CIS Guidance Document 31, Technical Report 2015-086.

²⁰ World Wildlife Fund - Keeping Rivers Alive - A Primer on Environmental Flows and Their Assessment, WWF 2009.

²¹ Government of Albania - Law 111/2012 on Integrated Water Resources Management, amended by the Law N° 6 of 08.02.2018 – Article 39 Use of Water Resources

²² Frontiers in Ecology and Environment - Global Proliferation of Small Hydropower Plants – Science And Policy. Front Ecol Environ 2018; 16(2): 91–100


prurjen ekologjike apo vazhdimësinë e ekosistemit. Të dy digat bllokojnë prurjen në rrjedhën e sipërme të lumit dhe devijojnë pjesën më të madhe të kësaj prurjeve për përdorim njerëzor, ujë të pijshëm, si në rastin e Bovillës dhe hidroenergjji, si në rastin e Murdharit. Gjithashtu, ka mundësi që këto nivele shfrytëzimi për ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, për ujitje gjatë muajve të verës, do të ndikojnë në prurjet ekologjike kritike.

9.3 Ndërlikimet dhe nevojat e ardhshme

Figura 9-1 tregon një nga praktikat më të mira të menaxhimit të prurjes ekologjike, ku prurja minimale ekologjike identifikohet për çdo muaj të vitit. Tipikisht, për të mbajtur statusin e mirë ekologjik të një trupi ujqor, duhet që 40% e prurjes të shfrytëzohet gjatë periudhës së lagësht të vitit (në muajt Mars, Prill) dhe kjo mund të reduktojë në më pak se 10% gjatë muajve të thatë të verës (për shembull Gusht, Shtator). Mbishfrytëzimi i më shumë sasi ujqore thjesht shkatërron statusin ekologjik të një trupi ujqor.

AMBU ka për detyrë, në zbatim të Direktivës 2000/60/EC, të parandalojë shkatërrimin e statusit të trupave ujqore.

Figure 9-1 – Best Practice Concept of Environmental Flow



Koncepti i prurjes ekologjike dhe aplikimi i saj në lejet e shfrytëzimit të burimeve ujqore në Shqipëri duhet të rishikohet dhe rivlerësohet, bazuar në opinionin e ekspertëve dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Këto praktika tregojnë se në momentin që nivelet e shfrytëzimit tejkalojnë 25-30% të prurjes mesatare vjetore, statusi i trupit ujqor do të jetë më pak se i "mirë". Rritja e niveleve të shfrytëzimit mbi 30% do të reduktojë akoma më tej statusin ekologjik të trupit ujqor. Këto shkatërrime do të kundërshtojnë në mënyrë direkte objektivat mjedisore të Direktivës Kuadër të Ujit.

9.4 Masat e mundshme për zbatim brenda planit të menaxhimit të basenit ujq

Tabela 9-1 – Veprimet e mundshme për Programin e Masave

9 – RRJEDHAT MJEDISORE	
Problematika të mundshme	Reagimi i nivelit drejtues për adresimin e problematikës
Marrja në konsideratë se prurja Q ₃₅₅ që është një prurje ekologjike minimale e pranuar, me shumë mundësi është e gabuar	Përcaktimi i konceptit dhe standartit kombëtar për ndryshimet minimale dhe maksimale të regjimit të prurjes duhet të rivlerësohet.
Shumë HEC-e mund të marrin sasi uji përtej limitit të prurjes ekologjike.	Procedura teknike standarte kombëtare të aplikueshme duhet të zhvillohen për të përcaktuar saktë prurjen ekologjike në përputhje me arritjen e statusit të mirë ekologjik sipas Direktivës kuadër të ujit.
Piku ujq i turbinave nga HEC-et mund të krijojë habitate të paqëndrueshme në rrjedhën e poshtme të shkarkimeve.	Procedura teknike standarte kombëtare të aplikueshme duhet të zhvillohen për të përcaktuar saktë nivelin e ndikimit të HEC-it të propozuar në statusin e koogjik të trupit ujq dhe ndikimin hidromorfologjik.

10. Përdorimi i ujit, nxjerrja e ujit dhe leja për nxjerrje

10.1 Rëndësia e kësaj tematike

Burimet ujore brenda baseneve ujore Ishëm dhe Erzen janë të fundme në sasi. Kjo nënkupton se bazuar në reshjet vjetore mesatare afat-gjata ne kemi një sasi fikse të mbushjes së rezervave ujore që furnizojnë çdo vit burimet sipërfaqësore dhe ato nëntokësore. Uji është një burim i çmuar dhe ne duhet të monitorojmë, menaxhojmë dhe shpërndajmë atë ndërmjet përdoruesve, sipas metodave dhe procedurave të mirëpërcaktuara. Kjo vlen për ujërat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore. Gjithashtu, për shkak të ndryshimeve klimatike sasia e rinovueshme në dispozicion për përdorim çdo vit është duke u reduktuar, në veçanti gjatë muajve të thatë të verës, kur burimet ujore janë në ulje.

Shfrytëzimi pa kontroll apo mbishfrytëzimi aktualisht janë impakte dëmtuese burimet tona ujore dhe në përgjithësi për trupat ujqorë dhe këto shfrytëzime duhet të rregullojnë më shumë në të ardhmen për të arritur një balancë të qëndrueshme ndërmjet nevojave ekonomike dhe mjedisore.

Ujërat nëntokësore gjithashtu, janë burime kritike dhe aktualisht furnizojnë sasi të mëdha të ujit të pijshëm dhe për ujitje të tokave bujqësore, veçanërisht në zonat bregdetare në Ishëm dhe në Erzen. Ka një ide se për shkak se ujërat nëntokësore janë në thellësi dhe të mëdha, aty gjendet "ujë me shumicë" në dispozicion për t'u përdorur. Praktikisht, ndonëse volumi i tyre është i madh, parametri kritik këtu është volumi i ujit mbushës. Vlera e volumit ujqor mbushës është rreth 15-25% e totalit të reshjeve në shumë basene ujore dhe si pasojë "uji në dispozicion për përdorim" është aktualisht vlerë shumë e ulët.

Shfrytëzimi i ujërave nëntokësore mbi këtë nivel do të reduktojë në mënyrë të përhershme dhe vazhdimisht nivelin e tyre statik. Kjo ka shumë ndikime të tjera: prurjet sipërfaqësore në lumenj do të reduktohen; do të rriten kostot e pompimit të ujërave nëntokësore; përqëndrimi i ndotësve në ujërat nëntokësore do të rritet; në zonat bregdetare kombinimi i rritjes së nivelit të ujit detar dhe reduktimi i nivelit të ujërave nëntokësore mund të rezultojë në hyrjen e kripëzimit të këto zona, duke ndikuar në burimet që shfrytëzohen për ujë të pijshëm dhe për ujitje.

10.2 Situata aktuale

AMBU është përgjegjëse për vlerësimin teknik dhe lëshimin e lejeve të përdorimit të burimeve ujore, por ka një ligjshmëri historike të përdoruesve të panumërt të ujit për furnizim me ujë të pijshëm dhe ujitje në bujqësi, të cilët operojnë pa këtë leje.

Së dyti, për shkak të dështimit të rrjetit të monitorimit hidromorfologjik që nga fundi i 1990, AMBU sot nuk është në gjendje të vlerësojë nga ana sasiore burimet ujore aktuale në basenet ujore. Përballë faktit global të emergjencës ndaj ndryshimeve klimatike²³, kjo

²³ BioSciences Journal - World Scientists' Warning of a Climate Emergency, Vol. XX No X, 2019

mungesë njohurie rreth burimeve ujore është e papranueshme dhe kërkon urgjentisht ndërhyrje. Ne nuk mund të mbështetemi në të dhëna të vjetra të periudhës 1960-1990 kur rrjeti hidrometereologjik funksiononte në mënyrë të pranueshme, pasi këto të dhëna sot janë të vjetra dhe nuk reflektojnë situatën aktuale.

Sipas procedurave standarte, shumë përdorues me leje sikurse ato industriale apo Hec-et nuk raportojnë në mënyrë të rregullt sasitë që shfrytëzojnë, tek AMBU. Kjo nënkupton që nuk mund të realizohet rishikimi apo kontrolli vjetor i balancës ujore. Kjo mungesë kontrolli, nga ana rregullotare, nuk është e qëndrueshme.

Është fakt i njohur (dhe i raportuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si pjesë e grupit teknik të ekspertëve) që shumë sisteme të furnizimit me ujë, humbjet reale (për shembull për shkak të rrjedhjeve) llogariten rreth 60% - 40% e ujit të shfrytëzuar arrin tek konsumatori. Kjo sasi e humbur (e cila vazhdimisht përbën presion dhe ndikim të dukshëm mbi burimet ujore) është e paqëndrueshme në terma afat-gjatë.

10.3 Ndërlikimet dhe nevojat e ardhshme

Pavarësisht nëse janë burime ujore sipërfaqësore apo nëntokësore, mbishfrytëzimi është plotësisht i paqëndrueshëm në terma afat-gjatë. AMBU është autoriteti përgjegjës që duhet të sigurojë në nivel vjetor, nevojat mjedisore + konsumin total të ujit nga burimet ujore nuk tejkalon burimet vjetore të rinovueshme. Kjo llogaritje duhet të realizohet veçmas për sistemet ujore sipërfaqësore dhe ato nëntokësore (njëkohësisht duke pranuar se këto sisteme ujore janë tepër të lidhura).

Megjithatë, për qëllim të llogaritjes së vazhdueshme të balancës ujore, AMBU duhet të kërkojë më tepër të dhëna të besueshme në krahasim me ato që janë vënë në dispozicion. IGJEUM, autoriteti përgjegjës, duhet të sigurojë të dhëna më cilësore hidrometereologjike, në mënyrë që llogaritja e mbushjes së baseneve ujore të bëhet më e saktë; së dyti, të gjithë përdoruesit që nxjerrin ujë duhet të detyrohen të raportojnë mbi sasitë e tyre në të paktën nivel sezoni, të paktën 4 herë në vit.

Duke patur parasysh që AMBU është përgjegjëse për sigurimin e shpërndarjes së ujit në mënyrë eficiente dhe efektive për përdorim ekonomik, është e nevojshme që brenda të njëjtit format raportimi të identifikohet produktiviteti ekonomik i ujit të përdorur, kështu që përdorimi jo eficient të mund të dallohet dhe përmirësohet.

Figure 10-1 – Example of a Simple Operator Quarterly Abstraction Report

Operator Data (Name/Location)	Water Quantity Abstracted	Water Quantity Returned	Water Lost in Operations	Pollutant conc. (BOD or other)	Units of Production
Operator Type 1 Municipal	MCM	MCM	MCM	Mg/l BOD ₅	Population
Operator Type 2 Industrial	MCM	MCM	MCM	Mg/l PO ₄	Product Units
Operator Type 3 Hydropower	MCM	MCM	MCM	-	Megawatt Hours
Operator Type 4 Agriculture	MCM	MCM	MCM	Mg/l NO ₃	Hectares

10.4 Masat që mund të zbatohen në Planin e Menaxhimit për Basenin Ujor

Tabela 10-1 – veprimet e mundshme për Programin e Masave

10 - PËRDORIMI I UJIT, NXJERRJA E UJIT DHE LEJA PËR NXJERRJE	
Problematika të mundshme	Reagimi i nivelit drejtues për adresimin e problematikës
Balanca ujore vjetore e basenit ujor aktualisht nuk njihet, pasi të dhënat mbi shkarkimet janë në dispozicion për periduhën 1960-1992.	Statusi aktual i balancës së ujit duhet rillogaritur duke përdorur të dhëna të fundit të besueshme. Duhet të zhvillohen procedura teknike standarte kombëtare për të krijuar dhe publikuar balancën ujore.
Përdoruesit nuk raportojnë rregullisht sasi të ujit që shfrytëzojnë ose nivelit e prodhimit, tek AMBU, ndaj strategjitë për shpërdarjen e ujit nuk mund të zhvillohen.	Një sistem raportimi standard ligjor i detyrueshëm për nxjerrje në ujërave duhet të zhvillohet me të gjitha të dhënat e grumbulluara në Kadastrën e ujit.
Regjistri i përdoruesve (një kërkesë e Direktivës kuadër të ujit, neni 11) është ngritur por i paplotë. Përdoruesit indistialë dhe ato të bujqësisë nuk janë të regjistruar.	Regjistri zyrtar i përdoruesve duhet azhornuar, standartizuar, dhe të gjithë përdoruesit duhet të detyrohen të raportojnë nivelet e ujit që shfrytëzojnë. Kërkohet bashkëpunim dhe koordinim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
Një numër i madh përdoruesish të paligjshëm dhe të peregjistruar në basen ujor, në mënyrë specifike për tokat e ujitshme bujqësore niveli i ujit të nxjerrë nga burimet sipërfaqësore dhe nëntokësore nuk njihet.	Forcimi i iniciativës për të regjistruar të gjithë përdoruesit me / pa leje duhet të bëhet në Kadastrën kombëtare të burimeve ujore.

11. Shkarkimet e ujit, ndotja e ujit dhe leja për shkarkim

11.1 Rëndësia e kësaj tematike

Shkarkimet e ujërave të ndotura janë ato prurje të cilat kthehen kryesisht në lumenj ose ujëra bregdetare pas nxjerrjes dhe përdorimit për ujë të pijshëm, industrial ose prodhimi hidroenergjie. Në rastin e ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotura urbane, pa një nivel të duhur trajtimi, sasi të mëdha ndotësish mund të shkarkojnë në trupat ujore sipërfaqësore, duke krijuar ndikim mjedisor shumë të madh për speciet ujore dhe reduktimin e statusit ekologjik të trupave ujore.

Legjislacioni europian siguron marrjen e masave ndaj ndotjes kimike të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nëpërmjet Direktivës 2000/60/EC, Direktivës 71/271/EEC, Direktivës 2006/118/EC. Të gjitha vendet e BE-së duhet të përmbushin kriteret e këtyre direktivave në termat e nivelit të mbrojtjes së ujërave pritës.


Direktivave e ujërave të ndotura kërkon grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane sipas aglomerimeve urbane me një popullsi ekuivalente >2000 banorë dhe trajtime më të avancuara për ato vende me popullsi ekuivalent > 10.000 në zonat sensitive. Qëllimi i kësaj direktive është siguri i mbrojtjes së mjedisve ujore nëpërmjet dy standarteve kryesore: i) ujëra të ndotura me NBO > 25mg/l, ii) lënda pezull jo më shumë se 35 mg/l për aglomerimet >10.000 P.E ose 60 mg/l për aglomerimet 2000 – 10.000 P.E.

Ndotja e burimeve ujore nga ujërat e ndotura urbane përbën një nga problemet më të mëdha në Shqipëri pasi ujërat nga zonat urbane përbajnë nivele të larta patogjenësh, nitrate, fosfatesh, amoniun, metale të rënda dhe hidrokarbone. Këto ujëra gjithashtu, përbajnë edhe sasi të mëdha lënde organike (60 mg/për / ditë NBO). Kjo sasi NBO hyn në mjedis ujore pritëse dhe konsumohet nga bakteret. Megjithatë, në këtë proces, veçanërisht kur përqëndrimi i NBO në lum është i lartë (tipikisht > 7.0 mg/l), konsumimi i oksigjenit nga bakteret shkakton mungesë të theksuar të oksigjenit në ujërat sipërfaqësore. Oksigjeni i shpërbërë është parametri i vetëm më i rëndësishëm në shëndetin e një lumit, pasi virtualisht të gjithë organizmat (peshqit, invertebrorët) kërkojnë nivele të larta të tij për të mbijetuar.

11.2 Situata aktuale

Aktualisht në Shqipëri trajtimi i ujërave të ndotura urbane nuk ekziston për shumë qytete dhe fshatra. Ujërat e zeza në pjesën më të madhe derdhen direkt në lumenj ose zonën bregdetare, apo kalojnë direkt në ujëra nëntokësore, duke krijuar nivele të larta ndotësish në shumë lumenj. Për shembull, figura 11 – 1 tregon që lumi Lana, Tirana dhe Ishëm janë lumenj të ndotur në pjesën e poshtme të tyre, të klasifikuar të jenë me status të “keq”. Shpesh raportohen vlera të NBO₅ nga 30-50 mg/l, nivele këto që janë të pamjaftueshme për të mbështetur jetën ujore. Për zonat gjysëm-urbane dhe ato rurale mënyra më e zakonshme për shkarkime të tyre janë gropat septike në bregdet. Këto instalime mbajnë materialin e ngurtë, ndërsa mbetjet e lëngëta infiltrojnë në shtresat e tokës, aty ku ujërat nëntokësore kontaminohen nga patogjenët dhe nutrientët.

Figure 11-1 – Physico-chemical Status of Main Rivers, Ishem-Erzen



Burimi: AKM

Aktualisht në këto basene ujore janë funksionalë dy impjante trajtimi, në Kavajë (120.000 banorë për t'u arritur në 2025) dhe Durrës (250.000 banorë jashtë sezonit turistik / 500.000 në sezonin veror, për t'u arritur në 2025). Një impjant i ri trajtimi pjesë e qytetit të Tiranës, i propozuar në Kashar u parashikua të vihej në funksion në 2016, por aktualisht i pezulluar për probleme kontraktuale. Impjanti do të shërbejë për të mbrojtur lumin Lana. Aktualisht, ky lum është një kanal i hapur ujërash të zeza.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti përgjegjës për lejet e shkarkimit të ujërave të ndotura. Megjithatë, dyshohet se shumë fabrika dhe aktivitete industriale po operojnë pa leje mjedisore dhe pa leje shkarkimi të ujërave të ndotura.

Hedhja në mënyrë direkte e mbetjeve të ngurta shtëpiake apo industriale në lumenj, është gjithashtu një problem i madh dhe krijon ndotje lehtësisht të dukshme me sy në korridoret e lumenjve dhe zonat e shkarkimit bregdetare.

11.3 Ndërlikimet dhe nevojat e ardhshme

Ministria e infrastrukturës dhe energjisë aktualisht po përgatit një draft VKM për miratimin e strategjisë së furnizimit me ujë dhe kanalizimet 2020-2030. Implikimet e kësaj strategjie, në të dy aspektet atë të rritjes së presionit ndaj burimeve ujore dhe presionet e ndotjes në mjedis, do të konsiderohen në mënyrë të kujdeshme në planin e menaxhimit të basenit ujqor.

Nivelet e ujërave të ndotura të patrajtuara dhe ndotësit që gjenden në lumenj, por specifikisht lumenjtë Lana dhe Tirana përbëjnë një nga kërcënimet më të mëdha mjedisore që kërkon veprim të përqëndruar në nivel kombëtar.

Një regjistër funksional dhe forcimi i të gjitha shkarkimeve industriale për të siguruar një tregues më të mirë të presionit të ndotësve nevojitet në mënyrë urgjente. Ka shumë mundësi që sistemi aktual i vlerësimit dhe miratimit të lejeve për ujërat e ndotura nuk është i duhuri, pasi lejet vlerësohen në mënyrë individuale pa marrë parasysh: i) kushtet dhe objektivat mjedisore për mjediset ujore pritëse ii) të gjitha shkarkimet kryhen në të njëjtin trup ujor, sikurse njihet si “qasja e kombinuar”.

11.4 Masat që mund të zbatohen në Planin e Menaxhimit për Basenin Ujor

Tabela 11-1 – Veprimet e mundshme për Programin e Masave

11- SHKARKIMET E UJIT, NDOTJA E UJIT DHE LEJA PËR SHKARKIM	
Problematika të mundshme	Reagimi i nivelit drejtues për adresimin e problematikës
Sistemet urbane të ujërave të ndotura shkarkojnë direkte duke i vendosur trupat ujore në kushte statusit të “keq”	Kërkohen investime kolosale infrastrukturore dhe planifikim afatgjatë. Kjo problematikë veshitirë të zgjidhet brenda kohëzgjatjes së këtij plani menaxhimi.
Sistemet e kanalizimeve rurale e gjysem-urbane shkarkojnë direkte duke i vendosur trupat ujore në kushte statusit të “keq”	Mundësi për të eksploruar zhvillimin e “tokave me strat filtri” për të siguruar trajtim në nivel lokal për shembull fshati SOS – projekti Pilot në Tiranë.
Hedhja e mebturianve urbane krijon presion ndotjeje	Promovimi i fushatave me bashkitë lokale për të ndryshuar kulturën e padrejtë të kthimit të lumenjve në kanale të depozitimit të mbetjeve. Forcimi dhe ndjekja ligjore e shkelësve.
Operatorë industrial të panumërt që shkarkojnë pa leje. Trajtimi në zonë i ujërave të ndotura mungon në shumë zona.	Regjistri i shkarkimit të ujërave të ndotura duhet të zgjerohet. Të gjithë operatorët industrialë duhet të identifikohet dhe regjistrohen në Kadastrën kombëtare. Forcimi i trajtimit në zonë.
Sistemi aktual i lejeve të shkarkimit nuk e zbaton “qasjen e kombinuar”. Ndaj efektet e kombinuara të shumë shkarkimeve nuk meret në konsideratë.	Lejet e shkarkimit duhet të përdorin metoda më të sofistikuara të analizave, duke marrë parasysh statusin e ujërave pritëse dhe shkarkimet ekzistuese.

12. Digat dhe hidrocentralet

12.1 Rëndësia e kësaj tematike

Vitet e fundit në Shqipëri, por dhe në Ballkan në përgjithësi, ka patur një shtim të digave dhe barrierave, e nxitur nga tarifat sponsorizuese shtetërore të cilat bien në kundërshtim me udhëzimet e BE-së për subvencionimin shtetëror për mbrojtjen e mjedisit dhe energjinë^{24 25}. Shumë nga këto skema janë konsideruar si HEC-e të vogla (< 10 MW), ndaj janë konsideruar edhe si me impakt të vogël apo “energji e gjelbër”.

Dukshëm në rritje, evidencat ndërkombëtare sugjerojnë që ndikimi mjedisor i digave dhe barrierave i shoqëruar me instalimet e HEC-eve të vogla po shkakton ndikime masive në ekosistemet ujore si pasojë e ndërtimit të digave dhe zënies së tokave, si dhe ndryshimet post-ndërtim dige në regjimin e rrjedhës ujore, humbjen e lidhjes së habitateve, dhe efektet kumulative të shumë instalimeve. Duke patur parasysh rëndësinë e përrrenjve furnizues në mirëmbajtjen e ndërlidhjes hidrologjike, korridoret e biodiversitetit dhe mbështetja e integritetit të ekosistemit në nivel rajonal, shtimi i pakontrolluar i instalimeve të prodhimit të hidroenergjisë përbën sot një problem kritik mjedisor për statusin e shumë trupave ujorë të ndikuar në Shqipëri²⁶.

Digat e HEC-eve jo vetëm që modifikojnë regjimin e prurjes në rrjedhën e poshtme, morfologjinë e kanaleve, dhe temperaturën e ujit, por gjithashtu ndikojnë në transport dhe depozitim të sedimenteve. Vendosja e digave në lumenj krijon probleme të mëdha nëpërmjet fragmentimit kritik të habitateve. Digat dhe barrierat e shoqëruara me HEC-e të vogla, përfaqësojnë barriera fizike për speciet migratore me rëndësi ekologjike, të cilat mbështeten tek lumenjt e lidhur për të lëvizur kështu në pjesën e sipërme për depozitim të vezëve, për të aksesuar zonat e përmytshme dhe për të migrimin në pjesën e poshtme.

12.2 Situata aktuale

Në basenet ujore Ishëm dhe Erzen janë ndërtuar dy diga kryesore të mëdha që nga viti 1998, Bovilla e përdorur për furnizim me ujë të pijshëm të qytetit të Tiranës (digë në lumin Tërkuzë) dhe Murdhari për qëllim prodhim hidroenergjie (digë në përroin Murdhari). Në të dy rastet, ndikimi i përfundimit të lidhjes së habitateve, nuk janë marrë në konsideratë skemat për mirëmbajtjen e prurjes ekologjike. Për shembull, nuk ka asnjë kompensim të prurjes që shkarkohet nga Bovilla në përroin Tërkuza.

Instalimet e HEC-eve janë të pakta, por janë identifikuar të paktën 11 instalime ekzistuese apo të planifikuara (figura 2-2). Propozimi për të krijuar një digë dhe një HEC në Malin e Djatit – Park Kombëtar, është i një rëndësie shumë të veçantë. Shqipëria ka nivelin më të lartë të zhvillimeve të fundit në sektorin e hidroenergjisë, pjesa më e madhe e tyre

²⁴ World Wildlife Fund - Hydropower pressure on European Rivers - The story in numbers, 2019

²⁵ CEE Bankwatch Network - Western Balkans hydropower Who pays, who profits?, 2019

²⁶ CEE Bankwatch Network - Broken rivers - The impacts of European-financed SHPPs on pristine Balkan landscapes, 2017

klasifikuar si HEC-e të vogla²⁷. Figura 12-1 sugjeron që Shqipëria do të operojë deri në 700 HEC në nivel kombëtar brenda 2030.


Aktualisht, procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe ato rregullatore për operimin dhe rregullimin e tyre janë shumë të dobëta. Nevoja për të rregulluar dhe kontrolluar në çdo sezon nxjerrjet e ujit dhe shkarkimet, për të minimizuar kështu ndikimet e “pikut ujqor” në kohë kritike në aspektin ekologjik, në përgjithësi as nuk është rregulluar dhe as zbatuar.

Figure 12-1 – Existing and Planned Hydropower in Albania

Country	Existing					Planned					Under construction				Total	
	0,1- <1	1-<10	10-50	50- 100	> 100	0,1- <1	1-<10	10-50	50- 100	> 100	0,1- <1	1-<10	10-50	50- 100		> 100
Albania	58	103	11	3	4	177	241	25	9	1	22	30	7		1	692

Burimi: www.balkanrivers.net

Figure 12-2 – Identified Existing and Planned Hydropower in Ishem-Erzen



Burimi: www.ecoalbania.org

²⁷ RiverWatch - Hydropower Projects in Protected Areas on the Balkans, 2015

12.3 Ndërlikimet dhe nevojat e ardhshme

Ka një nevojë urgjente për të zhvilluar një metodë kombëtare të qëndrueshme dhe ekologjike për të vlerësuar të gjitha instalimet e HEC-eve, nga digat e mëdha në HEC-et e vogla. Metodologjia e mbrojtjes së prurjes minimale ekologjike teknikisht është jo e drejtë, dhe virtualisht asnjë nga HEC-et nuk operon me një plan zyrtar menaxhimi të prurjes ekologjike.

Ndikimi i shumicës së HEC-eve në regjimin e prurjes në rrjedhën e poshtme dhe statusin ekologjik të trupave ujore nuk po vlerësohet korrekt. Si pasojë shumë HEC-e do të dështojnë në testin themelor të “mos-shkatërrimit” të statusit të trupave ujore, i kërkuar nga Direktiva Kuadër e Ujit.

12.4 Masat e mundshme për zbatim brenda planit të menaxhimit të basenit ujor

Tabela 12-1 – Veprimet e mundshme për Programin e Masave

12 - DIGAT DHE HIDROCENTRALET	
Problematika të mundshme	Reagimi i nivelit drejtues për adresimin e problematikës
Regjistri i shfrytëzimit për hidroenergj i publikuar nuk është zhornuar në mënyrë korrekte.	Një regjistër zyrtar i shfrytëzimit të ujërave përbën kërkesë ligjore të Direktivës kuadër të ujit neni 11. Regjistri duhet të rishikohet për të përfshirë atributet e nevojshme që lejojnë vlerësimin korrekt të ndikimeve mjedisore dhe të prurjes së HEC-eve.
Nuk ka një procedurë standarte kombëtare për të identifikuar në mënyrë transparente ndikimet e sakta hidromorfologjike të çdo HEC-i dhe ndryshimet rrjedhimore në statusin e trupit ujor.	Nevojitet zhvillimi i procedurave teknike standarte në përputhje me BE dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Ndryshimi i mundshëm në statusin dhe ndikimet mjedisore duhet të publikohen me transparencë.
Nuk ka një metodë teknike për të vlerësuar ndikimet kumulative të shumë HEC-eve në të njëjtin lum.	Duhet të zhvillohet një mjet vlerësimi për të përcaktuar për lejet brenda kontekstit të shumë HEC-eve, tashmë të autorizuara.

13. Përdorimi, mbrojtja dhe monitorimi i ujërave nëntokësore

13.1 Rëndësia e kësaj tematike

Në dekadat e fundit fokusi për ujërat nëntokësore më tepër ka qënë lidhur me përdorimin e tyre për furnizim me ujë të pijshëm. Rreth 75% e qytetarëve të BE-së mbështeten në këto burime për furnizimin me ujë të pijshëm. Megjithatë, politikat e BE-nuk duhet t'i konsiderojnë ujërat nëntokësore si në dispozicion vetëm për furnizimin me ujë të pijshëm, por duhet edhe t'i mbrojnë ato për vlerat e tyre mjedisore.

Ujërat nëntokësore përfaqësojnë një lidhje të rëndësishme të ciklit hidrologjik nëpërmjet mirëmbajtjes së shtretërve me filtra dhe prurjes së lumenjve, duke u sjellë si zonë buferike gjatë periudhave të thatësirës. Ujërat nëntokësore janë një komponent kritik i prurjes së lumenjve, shumë nga të cilët përdoren për furnizim me ujë të pijshëm dhe rekreacion. Ndaj, shkatërrimi i sasisë dhe cilësisë së tyre mund të ndikojë direkte në ekosisteme të tjera të lidhura me të, tokësore apo ujore qofshin.

Karakteri i fshehur i ujërave nëntokësore e bën të vështirë menaxhimin e duhur të qëndrueshëm të sasisë ose të ndikimeve të ndotjes, duke rezultuar në mungesë të ndërgjegjësimit dhe/ose evidencës për sa i përket nivelit të riskut dhe presioneve.

Politika e ujërave nëntokësore e BE-së dhe menaxhimi në nivel të lartë përcaktohet nga Direktiva 2000/60/EC, Direktiva 2006/118/EEC, Direktiva 91/676/EEC. Në shumë lumenj të Shqipërisë, 30-40% e prurjes vjetore vjen si devijim i ujërave nëntokësore. Në periudhat më prurje të ulët, gjatë verës, më shumë se 90% e prurjes në disa lumenj mund të vijë nga ujërat nëntokësore.


13.2 Situata aktuale

Ujërat nëntokësore në Shqipëri furnizojnë pjesën më të madhe të popullsisë dhe disa puse të mëdhenj ende janë funksionale për qytetin e Tiranës. Këto ujëra gjithashtu, janë një burim i rëndësishëm për industrinë dhe ujitjen në basenet Ishëm dhe Erzen.

Pjesa më e madhe e zonave perëndimore janë të përshkruara nga një akuifer i gjerë aluvial produktiv, me shumë puse të hapura (sondë) duke i shërbyer banorëve të zonës (figura 13-1). Qyteti i Tiranës shfrytëzon rreth 14% të sasisë që shkarkohet nga ujërat nëntokësore (burimet malore) nga puse të mëdhenj të Qaf Mollës, Laknas, Bërxull, dhe Pishina. Qyteti i Durrësit e merr pjesën më të madhe të furnizimit për ujë të pijshëm nga puset e hapura në Fushë-Krujë dhe akuiferin e Fushë-Krujës. Akuiferët karbonatike sigurojnë burime ujore të rëndësishme dhe eficiente nëpërmejt tubacioneve direkte në burim drejt zona të mëdha urbane sikurse Tirana, Kruja, përfshi Selitë, Shën Mëri dhe burimet e vjetra të Bovillës.

Nxjerrjet e ujërave nëntokësore duhet të rregullohen nëpërmjet sistemit të lejeve të nxjerrjes, për të cilën AMBU është institucioni përgjegjës. Monitorimi i statusit sasior të ujërave nëntokësore dhe kushtet e tyre fiziko-kimike janë përgjegjësi e SHGJSH, përgjegjës për të dhënë ekspertizë teknike për identifikimin e atributëve gjeologjike dhe statusin e akuiferëve të përdorur për furnizim me ujë të pijshëm.

Figure 13-1 – The Main Alluvial Aquifers in Ishem-Erzen Basin



Referuar raporteve të SHGJSH-së ndonëse monitorimi rutinë i statusit cilësor të akuiferëve kryesorë është kryer disa herë në vit në pikat e nxjerrjes, akoma nuk ka observime të shpimeve të pa ndikuara nga regjimi i pompave/nxjerrjes. Rrjedhimisht balanca vjetore e ujërave nëntokësore nuk realizohet. Nuk ka një inventar të detajuar të burimeve ujore. Puset e ujërave nëntokësore janë përdorur gjerësisht (shpeshherë pa leje) për ujitje dhe kjo ka ndikime negative në burimet e ujërave nëntokësore, veçanërisht në zonën bregdetare ku këto burime janë pothuajse të mbishfrytëzuar (për shëmbull Tiranë, Fushë-Krujë). Koeficienti i përdorimit për Tiranën dhe zonën e Fushë-Krujës është rreth 0.80-0.95²⁸.

13.3 Ndërlikimet dhe nevojat e ardhshme

Ka një presion të konsiderueshëm në burimet ujore nëntokësore dhe ky shfrytëzim kërkon urgjentisht evidenca të shtuara teknike dhe një regjim menaxhimi proaktiv. Burimi ujqor nëntokësor vjetor i rinovueshëm kërkon një llogaritje të saktë e të plotë të balancës së ujit, e cila kërkon një rrjet të përmirësuar të observimit të shpimeve.

Përdorimi i gjerë i ujërave nëntokësore për ujitje pa lejen e duhur, duhet të merret në kontroll nga AMBU-ja. Të gjitha nxjerrjet duhet të rregullohen në mënyrë shumë strikte. Identifikimi i të gjithë trupave ujorë nëntokësore të përdorur për furnizim me ujë të pijshëm ose me rëndësi ekologjike, duhet t'i nënshtrohet menaxhimit të cilësisë dhe sasisë së tyre, dhe kjo është një nga kërkesat e Direktivës Kuadër të Ujit dhe Direktivës së Ujërave Nëntokësore. Ky identifikim nuk është realizuar ende. Në mënyrë kritike, edhe zonat e

²⁸ Albanian Geological Survey - Inventory Of Groundwater Resources and Their Utilisation Patterns, CEMSA Project 2012

mbrojtjes higjeno-sanitare, për këto burime ujore nëntokësore, nuk janë përcaktuar dhe hartëzuar ende.

13.4 Masat e mundshme për zbatim brenda planit të menaxhimit të basenit ujqor

Tabela 13-1 – Veprimet e mundshme për Programin e Masave

13 – PËRDORIMI, MBROJTJA DHE MONITORIMI I UJËRAVE NËNTOKËSORË	
Problematika të mundshme	Reagimi i nivelit drejtues për adresimin e problematikës
Koeficienti i shfrytëzimit sugjeron që nxjerrja e ujërave nëntokësore mund të jetë e paqëndrueshme së shpejti.	Duhet të realizohet një balancë vjetore e ujit në bashkëpunim me SHGJSH me qëllim që nxjerrjet totale të jenë më pak se burimet e rinovueshme vjetore.
Shumë pika shfrytëzimi janë të paligjshme. Shumë pika shfrytëzimi janë të panjohura.	AMBU duhet të realizojë kontrole në terren dhe të nrejë një regjistër të plotë të të gjitha pikave të shfrytëzimit në Kadastrën kombëtare të ujit.
Ujërat nëntokësore aktualisht janë të paidentifikuara ose karakteristikat dhe presione të tyre në përputhje me Shtojcën II të Direktivës së ujit nuk dihen.	Karakterizimi fillestar dhe i mëtejshëm individual i trupave ujqore duhet të kryhet në përputhje me procedurat e përcaktuara kombëtare. Kjo kërkon bashkëpunim ndërmjet AMBU dhe SHGJSH.
Burimet ujqore nëntokësore të përdorura ujë të pijshëm nuk mbrohen si duhet. Shumë nga këto burime janë brenda zonave urbane ndaj janë në nrisk të madh nga ndotja.	Burimet ujqore kryesore duhet të hartëzohen dhe të përcaktohen me zonat e mbrojtjes higjieno – sanitare. Ëkto harta duhet të jenë publike për autoritetet bashkiake për zhvillimin e kontroleve të tyre.
Trendet e ndotjes së ujërave nëntokësore dhe nivelet e substancave prioritare nuk kuptohen mirë ose nuk publikohen. Rrjeti i monitorimit është jo i duhur për të përcaktuar statusin e trupave ujqore kryesore.	AKM dhe AMBU duhet të bashkëpunojnë për të publikuar vlerat dhe trendet e ndotësve të ujërave nëntokësore. Rrjeti i monitorimit duhet të rivlerësohet dhe të financohet për të garantuar përcaktimin e statusit të të gjithë trupave ujqore.

14. Cilësia dhe habitatet e ujit të bregdetit dhe ujërave të larjes

14.1 Rëndësia e kësaj tematike

Ujërat bregdetare janë të një rëndësie të veçantë në planin e menaxhimit të basenit ujor. Zonat bregdetare janë subjekt i presioneve të potenciale ndotjeje nga shkarkimet e lumenjve; shumë zona bregdetare ofrojnë habitate të rëndësishme dhe ligatina për specie të rëndësishme; plazhet bregdetare janë burime të rëndësishme me vlera ekonomike nëpërmjet turizmit.

Direktiva e ujërave të larjes 2006/7/EC ruan shëndetin publik dhe pastron ujërat e larjes. Vendet anëtare duhet të monitorojnë dhe vlerësojnë ujërat e larjes për të paktën dy parametra bakterologjike (fekale). Më tej, ato duhet të informojnë publikun rreth menaxhimit të plazhit dhe cilësisë së ujërave të larjes nëpërmjet të ashtuquajturës profileve të ujërave të larjes. Këto profile përmbajnë informacione mbi llojin e ndotësve dhe burimet që ndikojnë në cilësinë e tyre dhe janë rrezik për shëndetin e vizitorëve (sikurse shkarkimet e ujërate të ndotura).

Politika e BE-së për detin dhe bregdetin nëpërmjet Direktivës 2008/56/EC ofron bazë ligjore për BE-në për të mbrojtur dhe pastruar bregdetin, detin dhe oqeanet si pjesë e një strategjie të integruar, e cila do të na lejojë përdorimin e qëndrueshëm të tyre ²⁹.

Agjencia Kombëtare e Bregdetit është autoriteti përgjegjës për politikën dhe rregullimin e promovimit të turizmit të qëndrueshëm përgjatë zonës bregdetare në vend.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ujërave të larjes nëpërmjet zbatimit të programit kombëtar vjetor të monitorimit.

14.2 Situata aktuale

Universiteti i Tiranës (FSHN) ka identifikuar presionet mbi erozionin dhe habitatet në zonat bregdetare për shkak të urbanizimit, specifikisht në Kavajë dhe zonat e deltës së Erzenit.

Mbetjet e ngurta në shumë zona bregdetare dhe plazhe përbëjnë një problem të përhershëm në Shqipëri; pjesa më e madhe e tyre vjen nga hedhja gjerësisht në pjesët e sipërme të lumenjve. Kjo sjell ndikime në habitate, shëndet dhe turizëm, si dhe ka një dimension ndërkombëtar, pasi sasi të mëdha përfundojnë në bregdetin / plazhet e Kroacisë ³⁰. Rritja e shpejtë e popullsisë dhe nivelet e larta të migracionit drejt qyteteve, ka rezultuar në një rritje prej 80% të prodhimit të mbetjeve të ngurta 2003 dhe 2010³¹.

Depozitimet e mbetjeve urbane dhe inerte, shkarkimet industriale , të ujërave të zeza të zonave të banuara, të ndotësve buqësor (pesticide, insekticide etj.), si dhe mungesa e

²⁹ https://ec.europa.eu/environment/marine/index_en.htm

³⁰ Albanian plastic pollution clogs beach on Peljesac", Dubrovnik Times, 15 March 2018.

³¹ European Environment Agency, Municipal Waste Management in Albania, EEA 2018.

menaxhimit të cilësisë së ujërave, kanë çuar në një degjenerim të përhapur të sipërfaqes së tokës dhe të ujërave sipërfaqësore në Lumin e Tiranës. Aftësia vetëpastruese e ujërave të këtij lumi, si pasojë e rritjes së urbanizimit nuk arrin të përballojë shkarkimet e ujërave urbane të patrajtuara duke vënë në rrezik shëndetin e banorëve dhe duke dëmtuar mjedisin ujor. Përgjatë shtratit të lumit nuk mungojnë hedhjet pa kriter të mbetjeve të cilat shpesh herë digjen duke çliruar në ajër elementë të dëmshëm.

Derdhjet e ujërave urbane të Babrrusë, Paskuqanit, Bathores dhe Kamzës kanë çuar në përqëndrime të larta të amoniumit, nitrateve dhe fosfateve. Sipas specialistëve këto vlera i tejkalojnë normat e Direktivës së BE. Vlerat e larta të këtyre elementëve, sidomos nitrateve, kanë nxitur eutrofikimin, lulëzimin e algave dhe vështirësi të ecurisë së mëtejshme të jetës. Rrezik shumë i madh është kalimi i nitrateve në ujin e pijshëm.

Gjithashtu, qyteti i Durrësit duke nisur që nga qendra e tij, e deri në periferi, ka probleme me sistemin e kanalizimeve të ujërave të zeza. Arsyeja kryesore është mungesa e investimeve ndër vite, e cila nuk ka qenë në raport me shtimin e numrit të popullsisë.

Si pasojë, pas reshjeve të shiut në qytet, shpesh ujërat e zeza dalin në sipërfaqe nga mungesa e kanalizimeve të ndara për ujërat e shiut dhe ato të zeza.

Ndërsa në periferi mungesa e kanalizimeve ka sjellë përdorimin e kanaleve bujqësore të ndërtuara përpara viteve 90', që shkrakohen në bregdetin e Durrësit. Kjo gjendje është larg asaj që parashikon ligji 111 / 2012, i ndryshuar, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore".

Figure 14-1 – Pamje e zakonshme gjatë bregdetit shqipëtar



Burimi: Alketa Misja

Koncepti i kësaj publikimi është financuar nga BE-ja dhe Agjencia Austriake për Zhvillim

Faqe | 14-2

14.3 Ndërlikimet dhe nevojat e ardhshme

Duhet bërë një vlerësim gjithëpërfshirës i kuadrit ligjor dhe institucional për ruajtjen e biodiversitetit detar dhe bregdetar dhe krijimin e zonave të mbrojtura në rajonin e detit Adriatik;

AMBU parashikon të hartojë dhe miratojë legjislacionin për mbrojtjen e ujërave detare, duke marrë parasysh të gjitha kërkesat e Direktivës 2008/56/EC

14.4 Masat e mundshme për zbatim brenda planit të menaxhimit të basenit ujor

Tabela 14-1 – Veprimet e mundshme për Programin e Masave

14 – CILËSIA DHE HABITATET E UJIT TË BREGDETIT	
Problematika të mundshme	Reagimi i nivelit drejtues për adresimin e problematikës

15. Ngritja e nivelit të ujit në bregdet, rreziku nga përmbytjet, erozioni dhe vërshimet


15.1 Rëndësia e kësaj tematike

Rajonet bregdetare natyrore të Shqipërisë përbëjnë një nga asetet më të rëndësishme natyrore të saj. Ka një numër të madh zonash ligatinore me rëndësi ekologjike dhe shkencore, dhe plazhe bregdetare dhe resortet janë një burim i rëndësishëm të ardhurash nga turistët.

Densiteti i lartë i ndërtimeve në vijën e parë të bregdetit dhe nivelet e turizmit në të ardhmen janë veçanërisht vulnerabël ndaj impakteve të ndryshimeve klimatike. Rritja e nivelit të ujit të detit përbën një nga kërcënimet kryesore të ndryshimeve klimatike. Për shembull, një rritje prej 48-61 cm për 2100 mund të rezultojnë në përmbytje të mëdha të shumë zonave bregdetare, të cilat masivisht dëmtojnë ekonominë bregdetare dhe mundësisht edhe duke sjellë zhvendosjen e detyruar të gjithë komunitetit aty³².

Trupat ujore bregdetare dhe tranzitore duhet specifikisht të përcaktohen dhe karakterizohen në planin e menaxhimit të basenit ujqor, megjithëse ka mundësi që zonat bregdetare do të menaxhohen nëpërmjet një programi të veçantë të menaxhimit të bregdetit ose një strategjie të mirëfilltë e zbatuar nga një autoritet përgjegjës, në këtë rast Agjencia Kombëtare e Bregdetit.

Figure 15-1 – Projected 10 Year Inundation Zones by 2050



³² Climate Central - FLOODED FUTURE: Global Vulnerability To Sea Level Rise Worse Than Previously Understood, 2019

15.2 Situata aktuale

Kërcënimet kryesore për zonën bregdetare shqiptare përfshijnë erozionin, mbipeshkimin, ndotjen dhe ndikimin potencial nga ndryshimet klimetike. Figura 15-1 tregon nivelin e dëmtimit të bregdetit në zonat në Durrës dhe Kavajë brenda 2050 në një bazë propabiliteti vjetor prej 10% duke prezumuar një skenar pesimist të ndryshimeve klimatike.³³

Erozioni bregdetar përbën një problem të rëndësishëm në rajonet veriore dhe qendrore bregdetare, veçanërisht në veri të qytetit Durrës.

Shkarkimet e sedimenteve nga lumenjtë janë të larta, të cilat shpjegojnë natyrën dinamike të zhvillimit të bregdetit deltaik.

Shqipëria ka përgatitur "Plani i Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar", nën mbikqyrjen e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit. Ky plan jep vizionin e zhvillimit të vijës bregdetare. Ai orienton zhvillimet sektoriale me rëndësi kombëtare në fushën e turizmit, mjedisit, transportit, energjisë, bujqësisë, kulturës etj., si dhe zhvillimet urbane në territoret që administrohen nga bashkitë.

Gjithashtu, Plani synon të vendosë një raport më të mirë midis kërkesave për investime të biznesit me zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurive historike, trashëgiminë kulturore, zonat natyrore të mbrojtura dhe njëkohësisht të parandalojë investimet në zona që shfaqin rrezik për jetën, natyrën e mjedisin.

15.3 Ndërlikimet dhe nevojat e ardhshme

Planet e menaxhimit të zonës bregdetare janë një kërkesë urgjente. Objektivat mjedisore të këtyre planeve duhet të jenë në përputhje me objektivat mjedisore të përcaktuara për ujërat tranzitore dhe trupat ujore bregdetare, sikurse janë përcaktuar në planin e menaxhimit të basenit ujqor.

³³ UNECE - Albania - Environmental Performance Reviews, Third Review, 2018

15.4 Masat e mundshme për zbatim brenda planit të menaxhimit të basenit ujq

Tabela 15-1 – Veprimet e mundshme për Programin e Masave

15 – NGRITJA E NIVELIT TË UJIT NË BREGDET, RREZIKU NGA PËRMBYTJET DHE EROZIONI	
Problematika të mundshme	Reagimi i nivelit drejtues për adresimin e problematikës